



**POLICIA  
E KOSOVËS**



# QASJA PROAKTIVE POLICORE

roli i policimit në bashkësi në identifikimin dhe parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm që shpie në terrorizëm

*“ngritja e besimit, bashkëpunimit dhe respektit në polici  
vetvetiu mundëson pranimin e informatave nga anëtarët e bashkësisë”*

# QASJA PROAKTIVE POLICORE

roli i policimit në bashkësi në identifikimin dhe  
parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të  
dhunshëm që shpie në terrorizëm

*“ngritja e besimit, bashkëpunimit dhe respektit në Polici  
vetvetiu mundëson pranimin e informatave nga anëtarët e bashkësisë”*



Botues:  
Policia e Kosovës  
Prill, 2017

Titulli i doracakut: **QASJA PROAKTIVE POLICORE**  
Roli i policimit në bashkësi në identifikimin dhe parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm që shpie në terrorizëm

Autor: **Mentor ÇAKOLLI**  
Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë

Lektor: **Leonora FEJZULLAHU - RUHANI**  
Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

Dizajni grafik: **Çajup KAJTAZI**  
Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

© 2017 **Policia e Republikës së Kosovës**  
Departamenti i Operacioneve  
Divizioni i Sigurisë Publike

[www.kosovopoliice.com](http://www.kosovopoliice.com)

© TË DREJTAT AUTORIALE TË REZERVUARA

# QASJA PROAKTIVE POLICORE

roli i policimit në bashkësi në identifikimin dhe  
parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të  
dhunshëm që shpie në terrorizëm



**PËRMBAJTJA:**

HYRJE,.....	7
QËLLIMI,.....	11
PËRKUFIZIMET, .....	14
<b>KAPITULLI I, .....</b>	<b>17</b>
<i>ÇKA ËSHTË RADIKALIZMI?</i>	
MODELI I “SHKALLËVE DREJT TERRORIZMIT”, .....	25
<b>KAPITULLI II, .....</b>	<b>35</b>
<i>INDIKATORËT QË SHPIJNË NË RADIKALIZËM DHE EKSTREMIZËM TË DHUNSHËM</i>	
INDIKATORËT E RADIKALIZMIT QË SHPIJNË NË AKTIVITETE TË DHUNSHME,.....	42
RADIKALIZMI I DHUNSHËM I MUNDËSUAR NGA INTERNETI,.....	43
UJQËRIT E VETMUAR (LONE WOLVS), .....	49
PËRPJEKJET DHE PLANIFIKIMET PËR T’U LARGUAR NGA VENDI, .....	51
INDIKATORËT E PLANIFIKIMIT TË AKTIVITETEVE TË DHUNSHME	
TERRORISTE – SHENJAT E HERSHME, .....	53
<b>KAPITULLI III,.....</b>	<b>57</b>
<i>ROLI I ZYRTARËVE POLICORË NË PARANDALIMIN E RADIKALIZMIT</i>	
<i>DHE EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM</i>	
FILOZOFIA E POLICIMIT NË BASHKËSI, .....	59
NDARJA SEKTORIALE, .....	62
KOMITETET LOKALE PËR SIGURI PUBLIKE (KLSP),.....	65
KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI – KKSBB ,.....	68
EKIPET VEPRUESE PËR SIGURI NË BASHKËSI – EVSB, .....	71
ROLI I ZYRTARËVE POLICORË NË PARANDALIMIN E RADIKALIZMIT DHE	
EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM, .....	74
POLICIMI NË BASHKËSI DHE NDËRLIDHJA ME POLICIMIN E UDHËHEQUR NGA	
INTELIGJENCA, .....	80
REFERENCAT, .....	84
PËRFUNDIM, .....	86

## LISTA E SHKURTESAVE

MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MAShT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MSH	Ministria e Shëndetësisë
PK	Policia e Kosovës
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
DRP	Drejtoria Rajonale Policore
DBNj	Departamenti i Burimeve Njerëzore
DPSÇL	Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore
DO	Departamenti i Operativës
DH	Departamenti i Hetimeve
DK	Departamenti i Kufirit
DRK	Drejtoria Rajonale e Kufirit
DShM	Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse
DT	Divizioni i Trajnimeve
DPBP	Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë
DIA	Drejtoria për Inteligjencë dhe Analizë
DTIK	Drejtoria e Teknologjisë Informative dhe Komunikimit
DKT	Drejtoria Kundër Terrorizmit
SIPK	Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës
SP	Stacionet Policore
PB	Policimi në Bashkësi
PUI	Policimi i Udhëhequr nga Inteligjenca
ZIMP	Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun
NjI	Njësia e Inspektimit
NjSOTKF	Njësia për Sigurimin e Objekteve të Trashëgimisë Kulturore dhe Fetare
NjRKRr	Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugorë
AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
KOK	Komiteti Olimpik i Kosovës
KKSB	Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
KLSP	Komiteti Lokal për Siguri Publike
EVSB	Ekipi Veprues për Siguri në Bashkësi
EDhRShT	Ekstremizmi i Dhunshëm dhe Radikalizmi që shpien në Terrorizëm
OJQ	Organizata joqeveritare

## HYRJE

Sot, me avancimin dhe dinamizmin e jetës së njerëzve në mbarë botën, edhe nevojat personale dhe shoqërore në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë janë shtuar dhe kanë ndryshuar jashtëzakonisht shumë. Meqë ndryshimi dhe përparimi i mënyrave të kryerjes dhe trendit të krimit, ndryshimi i mënyrës dhe zhvillimit të dinamikës së qarkullimit të njerëzve dhe mallrave, avancimi i shpejtë dhe përdorimi i madh i teknologjisë, vështirësitë e paraqitura në të kaluarën në aspektin e sigurisë në bashkësi kërkon një qasje pragmatike të organeve të zbatimit të ligjit. Një ndër nevojat elementare për zhvillimin e shoqërive demokratike padyshim është avancimi apo deri në një masë përsosmëria e sistemit të drejtësisë përmes ofrimit të shërbimeve të besueshme dhe cilësore për anëtarët e bashkësisë. Nëse bëjmë një analizë sipërfaqësore të zhvillimit të trendit krimi shohim se jo shumë dekada larg nga tani, krimet pothuajse janë paraqitur në forma klasike respektivisht nuk kanë pasur gamën e sotme të shënjestrës dhe shkatërrimeve shoqërore dhe infrastrukturore. Me aplikimin dhe avancimin e demokracisë janë avancuar edhe kërkesat e anëtarëve të bashkësisë në fushën e mirëqenies, punësimit, edukimit, religjionit, organizimit shoqëror etj.

Mirëpo, edhe pse sistemi demokratik është i instaluar jashtëzakonisht mirë në shumë shtete, një pjesë e anëtarëve të bashkësisë ende kultivojnë mendësinë dhe ideologjinë e trashëguar apo edhe importimin e saj nga vende jo shumë demokratike. Pikërisht, në këtë kontekst është shfaqur edhe ajo që quhet konflikti i gjeneratave apo mospajtimet ndërmjet interpretimeve të demokracisë duke përfshirë të gjitha elementet e saj.

Pikërisht, duke u nisur nga ky këndvështrim, ndikim në zhvillimin e kësaj mendësie tek anëtarët e bashkësisë në Republikën e Kosovës kanë ndikuar edhe destabilizimet dhe konfliktet e ndryshme të cilat kanë karakter të konfliktit për pushtet dhe i cili gërshetohet më pas edhe me ideologji të dhunshme dhe ekstreme religjioze apo sektare.

Fillimi i konfliktit të përgjakshëm në Siri për ndryshimin e pushtetit dhe instalimin e demokracisë në vend, ka pasur pasoja jashtëzakonisht negative për vetë qytetarët e vendit atje por edhe më gjerë. Ndryshimi i qasjes dhe përgjigjes së opozitës siriane kundrejt regjimit në pushtet përcillet edhe me ndarjen e grupit të kryengritësve të moderuar dhe



ndikimin e organizatave të tjera terroriste të cilat krahas opozitës së moderuar siriane fillojnë të operojnë në Siri, në kundërshtim të regjimit aktual. Pikërisht nga këto ndikime të organizatave terroriste nisin edhe vetë ndarjet brendapërbrenda tyre duke krijuar formacione të tjera të dhunshme terroriste të orientuara kundrejt regjimit por edhe kundër banorëve lokalë, kryesisht luftë sektare.

Me avancimin e ndarjeve të tilla brenda grupeve terroriste, fillojnë edhe intensifikimet e dhunës së ushtruar kundrejt banorëve lokalë, me qëllim të imponimit të qeverisjes së tyre konform rregullave të fesë islame gjithmonë nën pretendimin se ata janë grupi i drejtë të cilët interpretojnë librin e shenjtë islam në përpikëri. Duke e analizuar këtë lloj situatë, vërejmë se krahas grupit të kryengritësve të moderuar të cilët kanë rezistuar duke synuar rrëzimin e regjimit të Assadit, kanë filluar të operojnë edhe organizata terroriste si Al-Qaeda në Siri dhe Irak si dhe Al-Nusra si një krah i kahershëm i Al-Qaedas e më vonë krijohet edhe i ashtuquajtimi shteti islamik i njohur ndërkombëtarisht si “ISIS”, “ISIL” apo “DAESH”. Pikërisht, fillimet e hershme të konfliktit në Siri në vitin 2011, imazhet e tmerrshme nga luftimet të cilat pasqyronin viktimë kryesisht fëmijë, gra dhe pleq, propaganda e intensifikuar nga terroristët e ISIS-it në internet, respektivisht në rrejtët sociale, ka bërë që një numër i madh i të rinjve nga mbarë bota të radikalizohen duke udhëtuar dhe kontribuar fizikisht në luftimet “përkrahëse” të popullatës civile atje.

Kërcënimi më i madh aktualisht duket të jetë i ashtuquajtimi ISIS me bazë në Siri dhe Irak, por ë nuk përbën as kërcënimin e parë dhe as të fundit për nga natyra e tillë me të cilin bota bashkëkohore ka të ngjarë të përballet. Konfliktet e ndryshme në rajon dhe në vendet me të cilat një pjesë e popullsisë së Kosovës kanë lidhje religjioze, tradicionale, kulturore apo historike përbën burim tjetër i cili mund t’i tërheqë qytetarët e Republikës së Kosovës drejt radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Për Kosovën, ky kërcënim nuk është vetëm global por përbën edhe kërcënim lokal, i cili duhet të merret parasysh shumë seriozisht. Disa kosovarë janë joshur nga mesazhet radikalizuese, duke iu bashkangjitur dhe luftuar përkrah grupeve ekstremiste dhe terroriste dhe në shumë raste janë kthyer në Kosovë, pasi kanë qenë prezentë apo kanë kryer vepra të kundërligjshme në emër të idealit të tyre. Por, është e rëndësishme të dimë përse shkuan? Çfarë u ishte thënë, nga kush dhe pse u bënë të dëgjueshëm? Dhe më e rëndësishmja, çfarë mund të bëhet për të siguruar

që personat e prekur nga këto grupe të parandalohen nga përfshirja në veprime të dhunshme? Shumë nga këto pyetje janë adresuar përmes analizave që ka kryer Qeveria e Republikës së Kosovës në funksion të përgatitjes së Strategjisë për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që shpie në Terrorizëm - 2015-2020 <sup>1</sup>, si një politikë e koordinuar edhe me partnerët dhe miqtë tanë ndërkombëtarë, si dhe me një bashkëpunim të ngushtë edhe me komunitetet fetare, përfaqësuesit nga shoqëria civile, OJQ të ndryshme si dhe përfaqësues të mediave, duke synuar identifikimin e shkaqeve dhe parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Në këtë aspekt, Policia e Kosovës duke synuar ngritjen dhe forcimin e partneritetit me anëtarët e bashkësisë dhe akterët e tjerë që kanë interes ngritjen e sigurisë në bashkësi dhe sigurisë publike në përgjithësi, ka hartuar Strategjinë dhe Planin e Veprimit 2017-2021 “Policimi në bashkësi” <sup>2</sup>. Edhe Republika e Kosovës ka qenë e prekur nga kjo kampanjë shpërndarëse e ideologjive ekstreme dhe të dhunshme të organizatave terroriste të cilat kanë ndikuar aq shumë sa që edhe disa predikues fetarë në njëfarë forme kanë bërë thirrje që të ndihmohen banorët e Sirisë dhe të mbrohen nga regjimi i Assadit.

Duke u bazuar në statistika zyrtare të Policisë së Kosovës, që nga viti 2012 deri në muajin maj të vitit 2016 së paku 310 persona nga Kosova kanë udhëtuar për të marrë pjesë në luftërat në Siri dhe Irak. Nëse e shikojmë nga afër dhe këta persona i ndajmë sipas gjinisë atëherë nga ky numër kemi 238 persona të gjinisë mashkullore, 44 persona të gjinisë femërore dhe 28 fëmijë.

Nëse analizojmë personat që kanë shkuar nga vendet e rajonit por edhe shtetet anëtare të Evropës atëherë del se Republika e Kosovës për nga numri i banorëve është një ndër shtetet më të prekura nga dukuria e pjesëmarrjes së qytetarëve në luftërat e huaja dhe organizatat terroriste. Dukuria e rritjes së terrorizmit vendor të frymëzuar nga organizatat terroriste, me theks të veçantë ISIS, është një shqetësim jashtëzakonisht i madh lidhur me sigurinë e përgjithshme të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Edhe pse janë bërë studime të shumta rreth asaj se cilat mund të

<sup>1</sup> Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizimit që Shpie në Terrorizëm - 2015-2020

<sup>2</sup> Strategjia dhe Plani i Veprimit 2017-2021 “Policimi në bashkësi” [http://www.kosovopolic.com/repository/docs/1...Strategjia\\_dhe\\_Plani\\_i\\_Veprimit\\_2017-2021\\_-\\_Policimi\\_n%C3%AB\\_Bashk%C3%ABsi\\_.pdf](http://www.kosovopolic.com/repository/docs/1...Strategjia_dhe_Plani_i_Veprimit_2017-2021_-_Policimi_n%C3%AB_Bashk%C3%ABsi_.pdf)

jenë arsyet e të rinjve për t'iu bashkuar organizatave terroriste, sidoqoftë, indikatorët dhe faktorët shtytës dhe tërheqës për të marrë pjesë në këto aktivitete është vështirë për t'u shpjeguar apo parashikuar.

Duke u bazuar në këto hulumtime të realizuara në fushën e terrorizmit është e njohur se nuk ekziston ndonjë përcaktues që identifikon një person si terrorist tipik e as ndonjë përcaktues i cili do të tregonte udhëtimin e ndonjë personi deri tek të qenurit terrorist.

Zakonisht, rrugëtimi apo traseja e një individi deri tek thirrja "terrorist" zakonisht kalon nëpër një proces që mund të zgjasë me ditë, javë, muaj apo edhe vite, e që në terminologjinë e parandalimit dhe luftimit të terrorizmit quhet proces i radikalizimit. Gjithmonë duhet të dallojmë radikalizmin i cili nuk përcillet nga aktivitetet e dhunshme dhe radikalizmi i cili përcillet apo manifestohet përmes aktiviteteve të dhunshme.

Ky dallim është jashtëzakonisht i rëndësishëm, për shkak se nëse nuk e bëjmë dhe njohim dallimin e radikalizmit paqësor dhe atij të përcillet me aktivitete të dhunshme atëherë, mund të shenjtërojmë ndonjë grup të gabuar të njerëzve ku më pas vetë do të inkurajonim dhe kontribuonim në manifestimin e dhunës tek këta persona për shkak të shkeljes së të drejtave të tyre dhe linçimin me grupet terroriste. Personat e radikalizuar që manifestojnë dhunë për arritjen e qëllimeve të tyre cilat do qofshin ato, shihen qartë si armiq të sistemit demokratik në vend përderisa në anën tjetër, personat e radikalizuar por që nuk kanë sjellje apo nuk manifestojnë dhunë për arritjen e qëllimeve të tyre ndonjëherë mund të na shërbejnë si aleatë të fuqishëm në parandalimin dhe luftimin e dukurive negative, respektivisht terrorizmit<sup>3</sup>.

Qeveria e Republikës së Kosovës, me qëllim të parandalimit dhe luftimit të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm, që shpie në terrorizëm, ka hartuar Strategjinë për parandalimin e EDhRShT dhe planin e veprimit 2015-2020<sup>4</sup>. Gjithashtu, Policia e Kosovës me qëllim të avancimit të qasjes pro-aktive dhe ngritjen e nivelit të angazhimit të anëtarëve të bashkësisë në fushën e parandalimit të dukurive negative dhe krimeve të llojeve të ndryshme si dhe ndërlikohen e aktiviteteve me strategjitë e tjera, ka hartuar Strategjinë dhe planin e veprimit 2017-2021 "Policimi në bashkësi"<sup>5</sup>.

<sup>3</sup> BARTLETT, J Mr., BIRDWELL, J. Mr, KING, M. Mr "The edge of violence"

<sup>4</sup> Strategjia per Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshem dhe Radikalizimit që Shpie në Terrorizem - 2015-2020

<sup>5</sup> Strategjia dhe Plani i Veprimit 2017-2021 "Policimi në bashkësi" (Objektivat: 1. FUQIZIMI DHE AVANCIMI I Strategjia

dhe Plani i Veprimit 2017-2021 "Policimi në bashkësi" (Objektivat: 1. FUQIZIMI DHE AVANCIMI I PARTNERITETIT),

(2. NGRITJA E BESUESHMËRISË DHE KËNAQSHMËRISË SË PUBLIKUT ME PUNËN POLICORE) dhe (3.

BASHKËRËNDIMI I AKTIVITETEVE TË POLICIMIT NË BASHKËSI ME STRATEGJITË TJERA) [http://www.kosovopolice.com/repository/docs/1.\\_Strategjia\\_dhe\\_Plani\\_i\\_Veprimit\\_2017-2021\\_-\\_Policimi\\_n%C3%AB\\_Bashk%C3%ABsi\\_.pdf](http://www.kosovopolice.com/repository/docs/1._Strategjia_dhe_Plani_i_Veprimit_2017-2021_-_Policimi_n%C3%AB_Bashk%C3%ABsi_.pdf)

## QËLLIMI

Ky doracak është i përbërë me kapituj të ndryshëm ku trajtohen aspektet identifikuese dhe parandaluese të aktiviteteve që mund të vijnë nga radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm si dhe kapituj që trajtojnë veprimet policore, udhëzojnë dhe këshillojnë në ngritjen e performancës dhe kreativitetit policor në zbatimin e filozofisë së policimit në bashkësi.

Duke marrë për bazë hulumtime të ndryshme në tërë botën të realizuara në fushën e identifikimit, parandalimit dhe luftimit të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, është evidente se nuk mjafton trajtimi i terrorizmit vetëm përmes qasjes re-aktive apo represive kundrejt personave të dyshuar me prirje radikale dhe potencialisht me manifestim të dhunës, por rol të veçantë dhe mjaft të rëndësishëm paraqet edhe qasje pro-aktive apo qasje e butë ndaj kësaj dukurie. Realisht, trajtimi adekuat dhe me seriozitet i qasjes pro-aktive në parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, që potencialisht shpie në terrorizëm, është një qasje që ka rezultate afatgjata dhe parandalon përhapjen e ideologjive ekstreme tek popullata në përgjithësi.

Hartimi i këtij doracaku ka qenë një domosdoshmëri për zyrtarët policorë në kuptimin e drejtë të çështjeve që ndërliken me terrorizmin. Pothuajse shumica e vendeve të prekura nga dukuria e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm kanë zhvilluar doracak të tillë të cilët kanë mundësuar që zyrtarët e organizatave për zbatimin e ligjit, anëtarët e bashkësisë, bashkësitë fetare, bashkësitë e nxënësve/studentëve dhe shoqëria në përgjithësi të pajisen me njohuri elementare sa i përket identifikimit dhe adresimit me kohë të dukurive negative respektivisht indikatorëve që potencialisht paraqesin radikalizëm dhe ekstremizëm të dhunshëm.

Ky doracak kryesisht është hartuar duke qenë në dijeni rreth nevojës për një gjithëpërfshirje dhe koordinim të aktiviteteve në parandalimin dhe luftimin e terrorizmit, duke e parë të nevojshme informimin e zyrtarëve nga institucione të ndryshme rreth njohjes së indikatorëve potencialë të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm që shpie në terrorizëm; duke e parë të domosdoshme forcimin dhe angazhimin aktiv të bashkësisë në identifikimin, adresimin dhe parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.


Duke u bazuar në Strategjinë dhe Planin e Veprimit 2017-2021 “Policimit në bashkësi”<sup>6</sup> “respektivisht objektivat strategjike I, II dhe III, hartimi i këtij doracakut ka qëllim kryesor është që të shërbejë si një udhërrëfyes për zyrtarët e Policisë së Kosovës në zbatimin e parimeve të filozofisë së policimit në bashkësi të cilat do të kontribuonin në identifikimin dhe parandalimin e terrorizmit në përgjithësi.

Qëllim tjetër i hartimit të këtij doracakut është edhe informimi i qytetarëve në përgjithësi rreth rëndësisë së raportimit me kohë dhe bashkëpunimit me Policinë e Kosovës për të parandaluar mundësinë e përshkallëzimit të radikalizimit apo ekstremizmit tek personat e caktuar si dhe parandalimin eventual të aktiviteteve terroriste të cilat do të mund të kishin pasoja fatale për shoqërinë dhe infrastrukturën në përgjithësi në Republikën e Kosovës.

Njëherësh ky doracak do të kontribuojë që përmes ngritjes së performancës policore të avancohet imazhi i Policisë së Kosovës dhe të forcohet besueshmëria e anëtarëve të bashkësisë në organizatën policore<sup>7</sup>. Për t’u marrë me dukurinë e personave të radikalizuar potencialisht me sjellje të dhunshme ekstreme, kërkohet që të kemi një gjithëpërfshirje të anëtarëve të bashkësisë duke u nisur nga familja e ngushtë. Kur flasim për përfshirjen e anëtarëve të familjes së ngushtë në procesin e identifikimit, parandalimit dhe de-radikalizimit të mundshëm, shohim se roli i tyre është themelor kur e dimë se kontaktet e tyre me këta persona janë në baza ditore dhe se ata më së miri e njohin sjelljen e këtyre personave dhe vërejnë ndryshimet e tyre.

<sup>6</sup> Strategjia dhe Plani i Veprimit 2017-2021 “Policimi në bashkësi” (Objektivat: 1. FUQIZIMI DHE AVANCIMI I PARTNERITETIT), (2. NGRITJA E BESUESHMËRISË DHE KËNAQSHMËRISË SË PUBLIKUT ME PUNËN POLICORE) dhe (3. BASHKËRENDIMI I AKTIVITETEVE TË POLICIMIT NË BASHKËSI ME STRATEGJITË TJERA) [http://www.kosovopolic.com/repository/docs/1\\_Strategjia\\_dhe\\_Plani\\_i\\_Veprimit\\_2017-2021\\_-\\_Policimi\\_n%C3%AB\\_Bashk%C3%ABsi\\_-\\_pdf](http://www.kosovopolic.com/repository/docs/1_Strategjia_dhe_Plani_i_Veprimit_2017-2021_-_Policimi_n%C3%AB_Bashk%C3%ABsi_-_pdf)

<sup>7</sup> Strategjia dhe Plani i Veprimit 2017-2021 “Policimi në bashkësi” (Objektivat: 1. FUQIZIMI DHE AVANCIMI I PARTNERITETIT), (2. NGRITJA E BESUESHMËRISË DHE KËNAQSHMËRISË SË PUBLIKUT ME PUNËN POLICORE) dhe (3. BASHKËRENDIMI I AKTIVITETEVE TË POLICIMIT NË BASHKËSI ME STRATEGJITË TJERA) [http://www.kosovopolic.com/repository/docs/1\\_Strategjia\\_dhe\\_Plani\\_i\\_Veprimit\\_2017-2021\\_-\\_Policimi\\_n%C3%AB\\_Bashk%C3%ABsi\\_-\\_pdf](http://www.kosovopolic.com/repository/docs/1_Strategjia_dhe_Plani_i_Veprimit_2017-2021_-_Policimi_n%C3%AB_Bashk%C3%ABsi_-_pdf)

Modeli gjithëpërfshirës:<sup>8</sup>

Secili rreth i këtij modeli ka kontakt të ndryshëm me personin e ndjeshëm apo lehtë të manipulueshëm. Ndikim në ndryshimin e sjelljes dhe ideologjisë tek personat e ndjeshëm kanë më shumë anëtarët e familjes apo profesionistët në rrethin më brenda modelit se sa rrethet më jashtë. Për shembull, prindërit e një personi të ri janë në gjendje të shohin se djali i tyre që ka bërë ndryshime drastike të dukjes së tij dhe se gradualisht ka filluar të mbledh shokë të rinj duke i lënë anash shokët e vjetër të gjeneratës. Zyrtari policor i cili e sheh këtë djalosh për herë të parë nuk do të jetë në gjendje të shohë aq shumë sa ka ndryshuar ky djalë gjatë viteve të fundit e që në fakt ky ndryshim është shumë me rëndësi. Për këtë arsye është shumë me rëndësi që të zhvillojmë komunikim dhe transparencë të ndërsjellë ndërmjet të gjithë akterëve në të gjithë rrathët respektivë për të kuptuar mënyrën që të identifikojmë indikatorët potencialë që kontribuojnë në radikalizëm.

<sup>8</sup> TERRA Toolkit - Community Approach to Radicalization

## PËRKUFIZIMET<sup>9</sup>

**BASHKËSIA** - një grup etnik, fetar, gjuhësor, social, profesional, apo grupe tjera që kanë karakteristika apo interesa të përbashkëta, perceptohen apo perceptojnë veten si të dallueshëm në një mënyrë në shoqërinë brenda së cilës ata ekzistojnë.

**SIGURIA NË BASHKËSI** - nënkupton, por nuk kufizohet në një koncept që vështron paraqitjen e ndryshimeve fizike dhe sociale në përputhje me prioritetet e bashkësive në mjediset lokale si një mënyrë për parandalimin e krimit dhe çrregullimeve tjera. Kjo iu lejon qytetarëve të përcjellin dhe të marrin përfitime të plota nga jeta e tyre sociale dhe ekonomike pa frikë nga krimi, çrregullimet dhe fatkeqësitë.

**SIGURIA PUBLIKE** - nënkupton parandalimin dhe mbrojtjen nga ngjarjet që mund të kërcënojnë sigurinë e publikut të përgjithshëm nga rreziku i konsiderueshëm, të tillë si krimi dhe fatkeqësitë, të dyja natyrore dhe atë të shkaktuar nga njeriu.

**POLICIMI NË BASHKËSI** - nënkuptojmë një filozofi dhe strategji të organizimit (mënyrë e realizimit të filozofisë) që promovon veprime të bazuara në partneritet dhe bashkëpunim ndërmjet Policisë dhe komunitetit, me qëllim të arritjes së efektivitetit dhe efikasitetit në identifikimin, parandalimin dhe zgjidhjen e problemeve nga kriminaliteti dhe dukuritë negative, për të përmirësuar cilësinë e jetesës për të gjithë.

**POLICIMI I UDHËHEQUR NGA INTELIGJENCA** - (e njohur gjithashtu edhe si vendimmarrja e bazuar në analizat) nënkupton filozofinë e menaxhimit dhe modelin e punës, qëllimi i së cilës është që të arrihet parandalimi, zbulimi dhe zvogëlimi i krimit, duke shfrytëzuar produktet analitike që në mënyrë efektive dhe efikase drejtohen resurset policore në adresimin e prioriteteve policore, në theks të veçantë: (a) Targetimi i shkelësve, veçanërisht kriminelëve aktivë; (b) Menaxhimi i krimit dhe vendeve të çrregulluara, (c) Hetimi i krimeve dhe incidenteve të ndërlydhura, si dhe (d) Zbatimi i masave parandaluese, duke përfshirë

<sup>9</sup> Strategjia dhe Plani i Veprimit 2017-2021 "Policimi në bashkësi" [http://www.kosovopolic.com/repository/docs/1.\\_Strategjia\\_dhe\\_Plani\\_i\\_Veprimit\\_2017-2021\\_-\\_Policimi\\_n%C3%AB\\_Bashk%C3%ABsi\\_.pdf](http://www.kosovopolic.com/repository/docs/1._Strategjia_dhe_Plani_i_Veprimit_2017-2021_-_Policimi_n%C3%AB_Bashk%C3%ABsi_.pdf)



edhe bashkëpunimin dhe partneritetin lokal për të zvogëluar krimin dhe çrregullimet tjera.

**EKSTREM, EKSTREMIZMI:** mund të përkufizohet vetëm në lidhje me ideologjinë më të gjerë, që vepron p.sh. në kuadër të nacionalizmit ekstrem, ambientalizmit ekstrem, ekstremizmit fetar. Tipari përkufizues i ekstremizmit është refuzimi i një ose më shumë parimesh bazë të ideologjisë së saj kryesore. Një nacionalist i cili i konsideron pjesëtarët e të gjitha kombeve të tjera si inferiorë, ose që refuzon mundësinë e bashkëjetesës, apo beson se të tjerëve duhet t'u mohohen të drejtat, është një nacionalist ekstrem. Një besimtar fetar i cili dënon udhëheqësit ose pjesën më të madhe të anëtarëve të besimit të tij është një ekstremist. Ekstremistët nuk janë medoemos të dhunshëm.

**RADIKALIZMI:** procesi i miratimit të ideologjive ekstremiste dhe në disa raste shndërrimi në një ekstremist të dhunshëm.

**TERRORIZMI:** edhe pse terrorizmi ka formulime të ndryshme, ende nuk ekziston ndonjë përkufizim i saktë, preciz dhe unik lidhur me të, mirëpo një ndër përkufizimet mund të themi se është përdorimi i dhunës me qëllim të shkakimit të terrorit mbi popullsinë civile. Terrorizmi është një lloj i veçantë i ekstremizmit të dhunshëm.

**PARTNERITETI MIDIS POLICISË DHE BASHKËSISË** – nënkupton bashkëpunimin e ndërsjellë polici-qytetar me qëllim të identifikimit të hershëm të dukurive negative dhe konflikteve në bashkësi dhe bashkërisht të parandalojnë të njëjtat nga të cilat potencialisht mund të kemi pasoja serioze për vetë bashkësinë.

**KKSB** – nënkupton Këshillin Komunal për Sigurinë në Bashkësi, i themeluar në secilën komunë të Republikës së Kosovës.

**KLSP** - nënkupton Këshillin Lokal për Siguri Publike, i themeluar nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë, si një organ këshillues, në kuadër të një zone të caktuar në çdo komunë që është në interesin më të mirë për një punë efektive të Policisë në bashkësi;



**EVSB** - nënkupton Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi, që përbëhen nga zyrtarët komunalë, policia dhe udhëheqësit e bashkësisë. Qëllimi primar i punës së tyre është që të identifikojnë dhe adresojnë çështjet mbi krimin, sigurinë dhe kualitetin jetësor.

**OJQ** - nënkupton Organizatat joqeveritare të regjistruara në Zyrën për Regjistrim të OJQ-ve, pranë Ministrisë së Administratës Publike të Republikës së Kosovës.

## KAPITULLI I

### ÇKA ËSHTË RADIKALIZMI?

*Ky kapitull do të trajtojë procesin e radikalizmit deri tek manifestimi i dhunës. Gjithashtu, në këtë kapitull do të shtjellohet një koncept i shpjegimit të procesit të radikalizmit dhe mënyrat e angazhimit gjithëpërfshirës me theks të veçantë përfshirja e zyrtarëve policorë dhe anëtarëve të bashkësisë në identifikimin, adresimin dhe parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.*



Si radikalizohen individët? Pse individët përdorin dhunë dhe bëhen terroristë? Çka mund t'i motivojë individët që të kryejnë vrasje dhe shkatërrime kundrejt njerëzve të tjerë?

Këto janë disa pyetje që parashtrihen shumë shpesh nga ana e njerëzve në përgjithësi dhe të cilët janë kureshtar të dinë përgjigjet se me të vërtetë çka po ndikon që njerëzit të radikalizohen dhe të përdorin dhunë të paparë kundër njerëzve.

Sipas hulumtimeve të ndryshme botërore të cilat janë realizuar nëpër dekada, është konstatuar se nuk ekziston ndonjë rrugë e caktuar dhe unike e cila dërgon individët në radikalizëm të dhunshëm. Shpeshherë arsyeja se pse një njeri e merr armën apo ndonjë bombë dhe sulmon të tjerët është më shumë personale. Por në kuadër të këtyre hulumtimeve botërore mund të themi se në përgjithësi këta njerëz janë të lindur në një ambient të frustruar, me ndjenjën e mos respektit, përluljes dhe përbuzjes nga të tjerët, mungesës së njohurive rreth fesë, apo ndoshta edhe nga dëshira për të bërë ndryshime në aspektin socio-ekonomik.

Gjithashtu, ekstremistët e ndryshëm manifestojnë dhunë për arsye të nacionalizmit apo separatizmit apo për ndonjë arsye revolucionare. Me këtë nënkuptojmë se nëse nuk ka ndonjë rrugë të vetme për t'u radikalizuar dhe ekspozuar dhunë atëherë mund të vijmë në përfundim se nuk ekziston ndonjë profil i caktuar terrorist.

Përkufizimet e termit “radikalizëm” janë deri në njëfarë forme të deshifruara për shkak se në arenën politike termi radikalizëm kryesisht nënkuptohet në aspektin e zgjidhjeve të politikave. Njëherësh përkufizimi akademik zakonisht shihet si i ngjyrosur nga disiplina specifike dhe se shumica e tyre çalojnë nga mungesa e precizitetit në deshifrim. Shumica e përkufizimeve të radikalizmit deri më tani i referohen një procesi individual zakonisht të influencuar fuqishëm nga proceset e grupeve të ndryshme.

Gjatë këtij procesi, dominimi i aspektit politik refuzohet gjithashtu edhe mundësia e dialogut, kompromisit dhe tolerancës si mjete të vetme për arritjen e qëllimit apo ndryshimit. Tani më, dhuna adoptohet më shumë

si metodë për të arritur qëllimet e caktuara. Por, radikalizmi deri në një masë nuk shpie domosdoshmërisht në terrorizëm <sup>10</sup>.

Të menduarit radikal nuk do të thotë se është krim përderisa në vete nuk përmban aktivitete të dhunshme. Radikalizmi është një proces në të cilin individëve iu prezantohet një ideologji me mesazhe të cilat inkurajojnë lëvizjet nga ato tradicionale apo të moderuara në ideologji me përmbajtje të dhunshme sa i përket pikëpamjeve të zhvillimit shoqëror, religjioz, politik, kulturor etj.

**SHEMBULL (radikalizmi dhe ekstremizmi i pa dëmshëm):**

*Leoni është një person i cili është tifoz i flaktë i ekipit futbollistik Barcelona. Leoni është aq radikal sa që kur transmetohet ndeshje futbollistike në mes të Barcelonës dhe Real Madridit ai gjatë gjithë ndeshjes bërtet, shanë dhe nuk e lëshon telekomandën nga dora me frikën se mos ndokush do e ndërrojë kanalin televiziv. Madje ai është aq ekstrem në dashurinë ndaj këtij klubi futbollistik sa që një ditë para ndeshjes ai flet vetëm për mundësinë e fitores gjatë gjithë takimeve me shoqëri. Edhe atëherë kur gjatë diskutimeve në shoqëri, ndonjëri nga shokët është tifoz i Real Madridit ai largohet menjëherë nga tavolina duke e parë se nuk po ia del në imponimin e mendimit të tij se klubi futbollistik Barcelona është ekip më i mirë sesa Real Madridi. Mirëpo, pas përfundimit të ndeshjes futbollistike, Leoni prapë është shok i ngushtë dhe i dashur për shoqërinë e tij dhe ka mirëkuptim për shokët që janë tifozë të klubit kundërshtar të Barcelonës.*

Në këtë shembull shohim se Leoni është radikal dhe ekstrem dashamirës dhe tifoz i zjarrtë i klubit futbollistik Barcelona por që asnjëherë nuk përdorë mjete apo sjellje të dhunshme kundrejt shokëve që bëjnë tifo për ndonjë ekip tjetër. Përderisa personi është radikal dhe ekstrem në ndonjë sport, aktivitet, hobi apo të ngjashme, ai nuk paraqet kërcënim për shoqërinë dhe sigurinë kombëtare.

<sup>10</sup> TERRA Toolkit – Community Approach to Radicalization

**SHEMBULL (radikalizmi dhe ekstremizmi i pa dëmshëm):**

*Vjollca është një nënë e cila ka lindur tre fëmijë. Ajo është aq shumë e lidhur me fëmijë sa që nuk mund të paramendojë se ndonjë nënë me vetë dëshirë, për shkak të mosplanifikimit të familjes apo për arsye të thjeshta, i nënshtrohet procedurës së abortit. Ajo është jashtëzakonisht radikale kur kemi të bëjmë me temën e abortit. Ajo vazhdimisht kundërshton legjislacionin në fuqi i cili e lejon abortin në kushte të caktuara. Ajo madje në mënyrë ekstreme mbron mendimin e saj kundër abortit sa që shfrytëzon edhe rrjetet sociale për të pasqyruar mendimin e saj dhe dëmet që shkaktohen nga abortit jo vetëm për fetusin por edhe rrezikimin e nënës. Për më tepër Vjollca, me qëllim të informimit të qytetarëve respektivisht nënave ka hapur një faqe në internet e cila ekskluzivisht trajton planifikimin e familjes, këshilla gjatë shtatzënisë, këshilla pas lindjes dhe këshilla për edukimin e fëmijës dhe familjes në përgjithësi.*

Në këtë shembull shohim se Vjollca përkundër radikalizmit të saj në aspektin e ndalimit të abortit pa marrë parasysh rrethanat deri tek mbetja shtatzënë dhe ekstremizmit të saj për mos njohjen e ligjit që lejon abortin brenda një periudhe të caktuar, ajo nuk manifeston asnjë sjellje të dhunshme kundrejt grave që abortojnë apo personelit mjekësorë që mundëson procedurën e abortit por, ajo mundohet që në mënyrë paqësore të edukojë gratë dhe shoqërinë përmes këshillave që iu ofron përmes faqes së hapur në internet.

Ripërsërisim se, nëse përqafimi i ndonjë mendimi radikal për ndonjë çështje të caktuar nuk do të thotë se kemi shkelur ligjin përderisa ky mendim radikal nuk përcillet apo manifestohet me aktivitete të dhunshme.

Sidoqoftë, mendimi radikal mund të paraqesë kërcënim për sigurinë kombëtare atëherë kur një person me qëllim të arritjes së qëllimeve politike, ideologjike apo religjioze përdor format e dhunës.

Procesi i radikalizmit i cili potencialisht përcillet me dhunë nuk është ndonjë dukuri e re dhe procesi si i tillë nuk është i kufizuar në vetëm një grup të caktuar, klasë shoqërore, religjion, kulturë, nacionalitet, moshë apo të ngjashme.

Pa marrë parasysh nivelin e edukimit, ndër më të ndjeshmit dhe potencialisht lehtë të radikalizuar mund të jenë individët të cilët janë naivë, nuk kanë njohuri të mjaftueshme për çështje të caktuara dhe hulumtojnë për udhëzime dhe kërkojnë një mendim.<sup>11-12</sup>

### **SHEMBULL (radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm):**

*Arbeni është një besimtar tradicional i cili nuk i praktikon ritet fetare në mënyrë të rregullt dhe fenë e tij ai mendon se e njeh relativisht mirë. Por në fakt Arbeni është njeri naiv sa i përket dispozitave të ndryshme që posedon libri i shenjtë i besimit të tij. Duke e parë situatën e përgjithshme të zhvillimeve në botë, duke i parë luftërat sektare që zhvillohen në vende të caktuara, ai fillon të plotësojë vakumin e tij sa i përket mësimit të "drejtë" të fesë. Kështu, pas disa muajve ai fillon në njëfarë forme të përhapë idenë e praktikimit ndryshe të riteve fetare nga ajo tradicionalja. Këto mendime të tij në mënyrë të fuqishme kundërshtohen nga shoqëria e tij dhe familje. Pas disa përpjekjeve për të promovuar dhe përhapur idenë e tij, Arbeni fillon të mbyllet vetëm dhe të ndahet gradualisht nga shoqëria. Kjo "mbyllje" në vetvete i ka bërë të mundur Arbenit që të hulumtojë në faqe të ndryshme të internetit dhe në njëfarë forme të ndikohet nga ideologji të ndryshme ekstreme për të arritur qëllimin e përhapjes së mendimit të tij rreth praktikimit të fesë tek shoqëria e tij por edhe më gjerë. Pas disa muajve të hulumtimit intensiv në internet dhe rrjete sociale, Arbeni është i gatshëm që të përdorë dhunë të cilësdo natyrë për të treguar opinionit se ai ka të "drejtë". Dhe në një ditë të kobshme për shoqërinë e tij, derisa ata kanë qenë duke bërë tifo për ekipin e futbollit që atyre ju pëlqen dhe duke pirë disa lëngje alkoolike, Arbeni shfaqet papritmas tmerrësisht i frustruar dhe radikalizuar skajshmërisht rreth asaj se pse shokët e tij në këtë kohë nuk janë duke praktikuar ritet fetare dhe për më tepër ai tërbohët kur sheh alkoolin në tavolinën e shokëve. Ai menjëherë fillon me fyerje dhe sharje nga më të ndryshmet kundrejt shoqërisë së tij të vjetër. Si kundërpërgjigje, shokët e tij e ftojnë me gjakftohtësi Arbenin që t'iu bashkëngjitet për kafe dhe për ta parë ndeshjen e futbollit. Në këtë moment Arbeni humb kontrollin e sjelljeve të tij dhe duke i pasur parasysh udhëzimet nga ideologjia ekstreme e përvetësuar nga interneti, ai pa hezitim nxjerr revolen dhe shtien mbi shokët e vjetër..*

<sup>11</sup> SMITH, Angus. "Radicalization - A Guide for the Perplexed", Royal Canadian Mounted Police, 2009.

<sup>12</sup> "Radicalization 101", International Association of Chiefs of Police, Committee on Terrorism, 2012.

Në këtë shembull shohim se Arbeni nga një djalë i moderuar në aspektin e praktikimit të fesë dhe njohurive për të, nga një familje tradicionale e moderuar, papritmas kthehet në një përbindësh radikal me sjellje të dhunshme ekstreme. Madje, shohim se Arbeni duke qenë naiv dhe i luhatur në këtë fushë ai ndikohet jashtëzakonisht shumë nga shfletimi i internetit dhe rrjeteve sociale dhe se zgjidhjen e fundit për realizimin apo “edukimin” e shokëve të tij në fushën e religjionit e sheh duke përdorur dhunë brutale dhe fatale për ata. Edhe pse Arbeni në fillim ka qenë shumë i moderuar në praktikimin e fesë, më vonë është radikalizuar dhe si rezultat i mosarritjes së qëllimit të tij në faza të mëvonshme ai është ekstremizuar duke kundërshtuar çdo lloj bashkëpunimi dhe bashkëveprimit me shokë dhe në fazën finale, Arbeni përdor dhunë ekstreme për të arritur qëllimin dhe për të ushqyer ekstremizmin e tij fetar.

Një ekspert i njohur në fushën e ekstremizmit të dhunshëm ka konstatuar se “lagjja është shpesh çelësi” në lidhjen në mes të xhihadistëve dhe sugjeroi: “Nëse doni të hulumtoni një grup, shikoni se ku njëri prej anëtarëve të grupit ushqehet ose shëtitet, në lagje ose në internet, dhe ka të ngjarë të gjeni anëtarët e tjerë”.

Prandaj, mund të themi se ekzistojnë një numër motivesh tashmë të njohura që ndikojnë tek personat të cilët i përqafojnë bindjet radikale ekstremiste, si:

- Motivi ideologjik;
- Material;
- Aventurier;
- Dëshira për lidërsip;
- Ambienti socio-kulturor<sup>13</sup>

Çështja e radikalizmit deri tek manifestimi i dhunës është shumë komplekse dhe se për këtë proces nuk ekziston ndonjë shpjegim unik dhe i saktë. Sidoqoftë hulumtues të ndryshëm profesionalë dhe shërbime të ndryshme të sigurisë nga e mbarë bota kanë propozuar modele të ndryshme në mënyrë që më mirë të identifikojmë apo definojmë trajektoren e

<sup>13</sup> Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizimit që Shpie në Terrorizem - 2015-2020



përafërt të procesit të radikalizmit i cili shpie deri tek përdorimi i dhunës për arritjen e qëllimeve të cilësdo natyrë qofshin ato.

Sipas profesorit të njohur të psikologjisë zt. Fathali Moghaddam, radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm që shpie në terrorizëm është veçse një fenomen psikologjik në kuptimin e asaj që terroristët bëjnë përpjekje për të sjellë ndjenjën e terrorit dhe pasigurisë tek individët në bashkësi apo tek popullata në përgjithësi.

Në përgjithësi, terroristët nuk janë psikologjikisht abnormalë dhe se ata nuk janë të çmendur. Sipas tij, nëse i shikojmë të dhënat psikologjike, do të mund të shohim se ka shumë pak dallime në mes të terroristëve dhe popullatës së zakonshme në kuptimin e karakterit personal.<sup>14</sup>

Gjithashtu, një keqkuptim tjetër rreth angazhimit moral sa i përket terroristëve. Një nga dyshimet ka qenë se terroristët moralisht janë të paangazhuar. Natyrisht se kjo nuk është e vërtetë. Ata mund të jenë moralisht të paangazhuar nga trajtimi i shoqërisë por ata në mënyrë shumë aktive janë të angazhuar në moralin sa i përket ushtrimit të aktiviteteve terroriste.

Ekzistojnë disa modele të studimit të procesit të radikalizmit deri tek manifestimi i dhunës nga individët apo grupet e individëve. Një ndër modelet më të pranueshme i cili përdoret ndërkombëtarisht për identifikimin e procesit të radikalizmit të personit, mund të themi se është modeli i “shkallëve që dërgojnë në terrorizëm” (në anglisht “staircase to terrorism”) i profesorit të psikologjisë zt. Fathali Moghaddam pranë universitetit “George Town” të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.<sup>15</sup>


Profesori i psikologjisë nga universiteti “George Town” në mënyrë jashtëzakonisht interesante dhe në detaje e ka paraparë procesin e radikalizmit deri tek manifestimi i dhunës për arritjen e synimeve qoftë individuale apo grupe, e që ky aktivitet i dhunshëm është i barabartë me terrorizmin. Profesori në fjalë procesin e radikalizmit e ka paraqitur përmes modelit “shkallët që dërgojnë deri në terrorizëm”, në të cilin model ka paraqitur figurativisht katet e një ndërtese, që nga kati përdhësë deri në katin e pestë. Në secilin kat siç elaborohet nga profesori i nderuar,

<sup>14</sup> MOGHADDAM, Fathali M. “The Staircase to Terrorism, A Psychological Exploration”, *American Psychologist*, vol. 60, No 2, 2005.

<sup>15</sup> MOGHADDAM, Fathali M. “The Staircase to Terrorism, A Psychological Exploration”, *American Psychologist*, vol. 60, No 2, 2005.

përshkruhen personat të cilët jetojnë dhe mënyrën se si ata ndihen dhe në momentet kur ata fillojnë të ngjiten apo të kalojnë në katet e larta nga kati përdhesë.

**Modeli i “shkallëve drejt terrorizmit”:** <sup>16</sup>



<sup>16</sup>MOGHADDAM, Fathali M. “The Staircase to Terrorism, A Psychological Exploration”

0

Kati Përdhesë:  
PADREJSTËSIA PSIKOLOGJIKE E  
KUSHTEVE MATERIALE

**Shembull:** Individu ndihet deri në një masë të kënaqur me trajtimin nga shoqëria

Në katin përdhesë elementet si drejtësia dhe të trajtuarit adekuat janë themelore. Secili nga ne fillon duke qenë banor i katit përdhesë në ilustrim. Njerëzit në katin përdhesë janë njerëz të cilët aspak nuk kanë lidhje me terrorizmin e as që e shohin veten si të tillë, larg nga kjo. Njerëzit në katin përdhesë janë sikur të gjithë ne, të angazhuar në punë, shkolla, aktivitete të përditshme dhe çka është më me rëndësi në mënyrë psikologjike merremi me avancimin apo përsosmërinë e identitetit tonë, shpeshherë duke pyetur veten: “Çfarë personi jam unë?”, “Cilit grup të personave i përkas unë?”, “A jam i vlerësuar dhe i suksesshëm nga të tjerët?”, “A kam identitet pozitiv në shoqëri?”, “A jam unë më ndryshe se anëtarët e tjerë të bashkësisë apo grupit?”.

Njerëzit në katin përdhesë mundohen të bëjnë përmirësime pozitive në jetët e tyre siç edhe ne bëjmë përpjekje për përmirësim të jetës sonë çdo ditë. Qëllimet e njerëzve në katin përdhesë janë të njëjta me synimet tona. Mirëpo, disa nga individët në këtë kat nuk janë të kënaqur për arsye të ndryshme siç janë trajtimi jo fer dhe i pabarabartë me kolegët e tyre në aspektin politik, shoqëror, fetar apo profesional dhe se disa njerëz për shkak të pikërisht këtyre moskënaqësive fillojnë të ngjiten lart në katin e parë të ilustrimit (shkallët drejt terrorizmit).

1

Kati i Parë:  
MUNGESA E MOBILITETIT/  
ANGAZHIMIT SHOQËRORË

**Shembull:** Individu ka humbur vendin e punës dhe këtë çështje e shndërronë në personale sepse ndjehet se nuk është trajtuar fer.

Tani, ngjitja në katin e parë të ilustrimit nuk do të thotë se këta njerëz e mendojnë veten të jenë terroristë. Ata janë thjeshtë të pakënaqur me disa aspekte të të jetuarit dhe po mundohen që duke shkuar më lart në kate do të gjejnë zgjidhje. Ky është kati ku duhet të luftohet trajtimi jo i barabartë dhe jo fer. barabartë dhe jo fer. Kryesisht në katin përdhesë të ilustrimit

parashihen të jenë banorë të rinj të cilët bëjnë përpjekje që të avancohen qoftë në punë, shkollim apo mundësi të tjera për jetë më të mirë.

Në katin e parë të ilustrimit, sjellja e njerëzve karakterizohet më shumë nga nevoja për të kërkuar rrugë për angazhim apo përshtatje në shoqëri. Pra, në katin e parë të këtij ilustrimit sjellja e njerëzve më shumë definohet si sjellje e karakterit psikologjik.

Tema kryesore psikologjike është angazhimi apo përshtatja në shoqëri, individët mundohen të bëjnë progres në punësim, në arritje akademike në shkollë, arritje në karrierë, të bëjnë progres me fëmijët e tyre e kështu me radhë. Pra, sikur të gjithë ne.

Disa nga këta individë për shkak se janë shumë të frustruar sepse ende nuk po mund të gjejnë rrugë për të bërë progres sepse sipas tyre, rrugët në këtë kat janë të bllokuara për ta. Sipas autorit të këtij modeli, në shumicën e rasteve kjo vije për shkak të korrupsionit dhe sistemit pothuajse diktatorial në disa shtete, papunësisë së madhe, nivelit të ulët të arsimit etj.

Edhe në këtë kat, individët nuk e përjetojnë lirinë, konkurrencën e hapur të cilën ata e kërkojnë. Dhe prapë disa nga individët apo banorët e katit të parë vazhdojnë të ngjiten më lart për në katin e dytë të ilustrimit “shkallët drejt terrorizmit”.

## 2

### Kati i Dytë: ZHVENDOSJA E AGRESIONIT/ FRUSTRIMIT MAKSIMAL

**Shembull:** Individu ende është i pa punë ku tashmë ai fillon një retorikë të ashpër dhe frustrim.

Ky është kati i dytë i ilustrimit “shkallët drejt terrorizmit”. Në këtë kat procesi psikologjik i cili është shumë më rëndësi tashmë zëvendësohet me agresion apo frustrim maksimal. Tani, në këtë shkallë edhe ne gjatë përditshmërisë mund të kemi raste kur shfaqim agresion apo frustrim të tepruar.

#### **PËR SHEMBULL:**

Iliri ka pasur një ditë shumë të keqe në punë. Ai është fjalosur me shefin e Iliri ka pasur një ditë shumë të keqe në punë. Ai është fjalosur me shefin e tij. Kur Iliri futet në veturë për të shkuar në shtëpi, për ‘fat’ vetura nuk ndizet. Dhe pas disa minutave vetura ndizet dhe ai vazhdon rrugën për në shtëpi.

Por jo shumë larg dhe Iliri futet në një komunikacion të dendur e të bllokuar. Kur Iliri më në fund arrin në shtëpi, ai është i uritur, i lodhur nga puna dhe fillon t'i bërtasë fëmijës së vet dhe papritmas godet atë me një flakaresh. Dhe kur gruaja e tij e pyet e nervozuar se, pse e godite fëmijën? Iliri i përgjigjet se “kjo flakaresh do ta bëjë person më të mirë”. Unë vetëm i tregova atij se sa e vështirë është jeta atje jashtë.

Ky lloj i zhvendosjes së agresionit apo frustrimit është pjesë e përditshmërisë sonë. Sidoqoftë, në këtë kat, disa individë ndjehen se padrejtësia dhe trajtimi jo fer të cilin e kanë përjetuar nuk mund të adresohet përmes organeve legjitime që merren me trajtimin e tyre dhe se ky perceptim formon bazën për një moral të ri të veprimit. Kjo situatë është ku personi zhvillon interes për ideologji dhe zgjidhje radikale. Në fakt, individët në këtë kat janë relativisht të dëmshëm për shoqërinë përderisa grupet me ideologji radikale dhe ekstreme të dhunshme vijnë në këtë moment dhe i plotësojnë nevojat personave që gjenden në këtë kat.

Tani, kur individët nga kati i dytë vendosin t'i bashkohen një grupi radikal, ata ngjiten në katin e tretë.

### 3

#### Kati i Tretë: NDARJA NGA MORALI

Shembull: Individu është ende i pa punë, tani ai bindet se përdorimi i dhunës si opsion mund të jetë i arsyeshëm.

Pra, siç edhe e patë, disa individë janë ngjitur shkallëve drejt terrorizmit nga kati i dytë në katin e tretë të ilustrimit. Këta individë nuk kanë qenë vetëm të frustruar por ata tashmë ndjejnë aneksime të ndryshme dhe jo rehati rreth situatës së tyre dhe se ata tashmë janë drejtuar drejt shënjestrave të caktuara. Ata ngjiten në katin e tretë ku procesi kryesor psikologjik është ndarja nga morali i të gjithë neve, pra “shumicës” siç ata e konsiderojnë. Morali i cili thotë se të vrasësh është gabim dhe se terrorizmi është gabim, gradualisht zëvendësohet me moralin i cili lejon disa kushte apo të paktën terrorizmi arsyetohet deri në një masë.

Pra disa kushte apo të paktën terrorizmi arsyetohet deri në një masë. Pra, disa individë përvetësojnë këtë lloj të moralit që thotë se “nëse nuk mundeni t’i luftoni ata në ndonjë mënyrë tjetër, atëherë terrorizmi arsyetohet”. Tani, në katin e tretë, ky ndërrim i moralit i cili e përfaqon terrorizmin deri në një masë nuk nënkupton se ndokush në mënyrë të pa evitueshme do të bëhet terrorist në kuptimin e mënyrës së veprimit apo manifestimit. Kjo nënkupton vetëm një ndryshim në sjellje dhe qëndrim. Është histori e gjatë në psikologji e cila, nëse kthehemi në vitet e hershme të shekullit XX, rreth hulumtimit të qëndrimit dhe ndërlidhjet e tij me veprimet, ne e dimë se vetëm të qenit person i cili ekspozon ndonjë qëndrim të caktuar nuk do të thotë se ata do të përdorin edhe veprime për arritjen e qëndrimeve të tyre.

#### **PËR SHEMBULL:**

Ka shumë njerëz të cilët ekspozojnë qëndrimet e tyre rreth votimit në zgjedhje, por ata kurrë nuk votojnë për ndryshime apo ka njerëz të cilët kërcënojnë por ata kurrë nuk i realizojnë kërcënimet që bëjnë.

Pra, vetëm pse është një pranim apo miratim i terrorizmit në nivel moral nuk do të thotë se personi do të ndërmarrë ndonjë veprim ekstrem. Sidoqoftë, nuk do të thotë se ky person tani ka ndryshuar në një mënyrë të rëndësishme. Për këtë person morali bëhet një angazhim me terrorizmin duke e parë atë si një mjet apo veprim të arsyeshëm për të përfunduar padrejtësitë ndaj tij apo grupit. Gjithashtu, kjo prapë ndërlidhet me identitetin personal dhe grupor.

Përgjatë gjithë procesit të ilustrimit ‘shkallëve drejt terrorizmit’, tema e identitetit është ndër kërcënimet kryesore për individët por edhe për grupin. Kur njerëzit ndjehen se identiteti i tyre ka filluar direkt të kërcënohet apo ata tashmë janë të kërcënuar nga spastrimi, kjo është shumë me rëndësi dhe shërben për të motivuar ata për veprime ekstreme dhe të dhunshme. Tani si përgjigje, ne mund të themi se ky kërcënim apo perceptim për kërcënim duket të jetë jo i arsyeshëm. Sigurisht, ata nuk duhet të ndjehen se janë të kërcënuar kolektivisht apo të kërcënuar nga spastrimi.

Sidoqoftë, historia ka treguar se ka shumë arsye të forta që grupe të caktuara të ndjehen të kërcënuara.

**PËR SHEMBULL:**

Hulumtimi rreth vdekjeve linguistike apo të gjuhëve tregon se në 500 vitet e fundit, rreth 9000 gjuhë janë zhdukur apo spastruar. Kur Kolumbusi ka arritur në Amerikën Veriore në të gjithë botën janë folur rreth 15.000 gjuhë. Tani janë rreth 6.000 gjuhë.

Shumica e gjuhëve janë zhdukur apo spastruar. Shumë grupe ndjehen të kërcënuar nga globalizimi. Grupet e religjioneve tradicionale dhe fundamentale të të gjitha religjioneve ndjehen të kërcënuar nga globalizimi. Dhe veçanërisht, grupet e myslimanëve tradicionalë dhe fundamentalë ndjehen të kërcënuar nga globalizimi dhe liberalizimi i rolit të gjinive. Roli modern i gruas në shoqëritë tradicionale është kërcënim. Disa individë të cilët i janë bashkuar moralit që miraton apo pranon terrorizmin vazhdojnë tutje të ngjiten në katin e katërt të modelit të “shkallëve drejt terrorizmit”.

**4**

Kati i Katërt:

NE vs ATA

**Shembull:** Individii ende i pa punë tani i bashkohet grupit me interes të njëjtë dhe e bënë ndarjen apo pozicionohet në “NE kundër ATYRE”

Tani më kemi shkuar në katin e katërt të modelit “shkallët drejt terrorizmit”. Procesi kryesor psikologjik që tashmë zhvillohet dhe ndryshon në këtë nivel të ilustrimit është të menduarit kategorik apo bindja kategorike. Në katin e katërt stimulohet të menduarit e bindur në kontekstin e “ne kundër atyre” apo “ne kemi të drejtë, ata e kanë gabim”.

Të menduarit kategorik apo bindja kategorike u mundëson njerëzve të grupit (ne) të cilët tashmë kanë kaluar katet dhe kanë mbërrirë deri në katin e katërt që grupet apo njerëzit e tjerë t’i etiketojnë dhe t’i shohin si jo njerëzorë, gjynahqarë apo gjithçka tjetër që arsyeton ekstremizimin e tyre. Kjo lloj qasjeje dhe kjo mendësi e këtyre personave në katin e katërt u mundëson që njerëzit e tjerë apo grupet e tjera që nuk u përkasin atyre t’i trajtojnë në mënyrë jo njerëzore. Prapëseprapë, kjo nuk do të thotë se

njerëzit që tashmë gjenden në katin e katërt në mënyrë të pa evitueshme do të përdorin veprime terroristë kundrejt të tjerëve për t'i shkatërruar ata por, që kjo qasje e këtyre personave e rrit mundësinë potenciale për veprime terroriste. Ajo se çka mund të shohim në këtë nivel të modelit “shkallët drejt terrorizmit” që nga kati për dhese është se në çdo kat karakterizohet me procese të caktuara psikologjike për njerëzit dhe grupet e njerëzve. Pra, ne kemi këtë lëvizje graduale dhe të vazhdueshme të personave nëpër katet e modelit “shkallët drejt terrorizmit” ku këta persona tashmë në katin e katërt të ardhmen dhe rrugët e tyre për progres në jetë i shohin si të mbyllura dhe të mundura. Kjo do të thotë se personat në këtë nivel të modelit “shkallët drejt terrorizmit” janë jashtëzakonisht shumë të frustruar dhe të inatosur me të tjerët. Tashmë, këta persona në mënyrë të qartë dhe pa hezitim e shohin shënjestrën e tyre kundër të cilës do të përdorin agresion potencial. Dhe se në këtë rast ata e arsyetojnë shënjestrën e tyre duke respektivisht personat apo grupet që nuk mendojnë apo veprojnë si ata dhe se ata tashmë i konsiderojnë si jo njerëzorë apo gjynahqarë.

#### **PËR SHEMBULL:**

Tek shembulli i Vjollcës e kemi vërejtur se ajo është kategorikisht kundër abortit dhe e cila përkundër radikalizmit të saj në këtë temë dhe ekstremit të saj që në baza ditore të komunikojë me gra dhe personel mjekësor si dhe dhënien e këshillave përmes faqes së hapur në internet rreth gjynahut dhe aktivitetit të dëmshëm që paraqet aborti. Mirëpo, tashmë pas disa viteve të përpjekjeve për të ndryshuar këtë praktikë dhe për të ndaluar me ligj abortin, ajo kalon në veprime të tjera duke e krijuar një grup të personave që ndajnë mendimin e njëjtë me të dhe tashmë fillon etiketimin e personave të tjerë me NE kundër ATYRE që janë jashtë mendësisë dhe grupit të saj, siç përshkruhet në modelin “shkallët drejt terrorizmit” respektivisht në katin e katërt. Tashmë, duke e parë dhe duke vlerësuar se ajo në të kuptuarit e saj ka shterur të gjitha përpjekjet për të ndryshuar situatën që ndër lidhet me abortin, dhe në mënyrë që Vjollca të arrijë qëllimin e vet dhe të grupit të saj për ndalimin e abortit tashmë si shënjestër ka gratë të cilat kërkojnë të abortojnë dhe personelin mjekësor i cili kryen procedurat mjekësore për realizimin e abortit.



## 5

Kati i Pestë:  
ANASHKALIMI/MENJANIMI I  
KUFIZIMEVE NJERËZORE

**Shembull:** Individu i pa punë planifikon dhe realizon akte të dhunshme terroriste kundër qeverisë apo personave të tjerë si shënjestër.

Hapi i fundit në modelin “shkallët drejt terrorizmit” është ngjitja e disa personave nga kati i katërt në katin e pestë që nënkupton edhe anashkalimin apo mënjanimin e mekanizmave kufizues njerëzorë për veprime të caktuara. Tani, personat që gjenden në katin e pestë në vetvete i krijojnë mekanizmat anashkalues apo mënjanues të sjelljeve apo veprimeve njerëzore.

Siç e dimë, për të gjithë njerëzit vrasja e njerëzve është veprim jashtëzakonisht i vështirë, sidoqoftë, në këtë kat ekzistojnë mënyra të cilat anashkalojnë këto vështirësi dhe se tashmë personat që kanë arritur më herët në katin e pestë tashmë kanë zhvilluar strategji të ndryshme, me qëllim të anashkalimit apo mënjanimin të kufizimeve njerëzore në sjellje dhe veprime.

Faza finale në katin e pestë është padyshim veprimet dhe aktivitetet terroriste për të vrarë të tjerët që nuk janë si ata. Tashmë këto veprime nuk përfshijnë vetëm etiketimin e të tjerëve si jo njerëzorë dhe gjynahqarë por tashmë kjo mendësi dhe psikologji e terroristëve forcohet edhe më shumë duke arsyetuar fuqishëm veprimin e tyre dhe duke thënë se “me të vërtetë këta persona e meritojnë një agresion dhe terrorizim”.

Tashmë e kemi vënë re se ky proces i radikalizmit që shpie gradualisht në terrorizëm temë kryesore apo arsye kryesore për këtë është kërcënimin i identitetit personal apo edhe i atij grupor.

**PËR SHEMBULL:**

Vjollca në katin e katërt e ka krijuar atë ndarjen NE kundër ATYRE dhe tashmë ajo e ka një shënjestër të qartë për sjellje të dhunshme ekstreme dhe terrorizëm. Ajo tashmë është ngjitur në katin e pestë të modelit “shkallët drejt terrorizmit” dhe tani është bërë edhe ndërrimi i mendësisë në anashkalimin apo mënjanimin e frenimit natyral njerëzor.

Me qëllim të arritjes së qëllimit dhe ushqimit të ideve radikale në ndalimin e abortit, ajo së bashku me grupin e saj që ndajnë të njëjtën mendësi e që së bashku kanë arritur në katin e pestë të modelit “shkallët drejt terrorizmit” pas një planifikimi të mirë, sulmojnë një klinikë gjinekologjike-obstetrike, respektivisht vrasin në mënyrë brutale tre doktorë, katër infermierë dhe dy paciente shtatzëna që presin realizimin e abortit.

Profesori i nderuar Zt. Fathali Moghaddam në ilustrimin e procesit të radikalizimit apo modelin “shkallëve drejt terrorizmit” në mënyrë brilante paraqet ndryshimet e sjelljeve, mendësisë dhe veprimeve njerëzore deri tek qëllimi final për ndryshim respektivisht aktivitetet terroriste.

Kjo na bën të kuptojmë se sipas këtij modeli neve si shoqëri na nevojitet të krijojmë kushte dhe të zhvillojmë politika adekuate për secilin person individualisht që parashihet në udhëtimin respektivisht ngjitjen e tij në modelin “shkallët drejt terrorizmit”.

Neve na duhet të krijojmë politika afat mesme dhe afat gjata të cilat do të trajtojnë problemin e procesit të radikalizimit. Kjo do të thotë se nëse dëshirojmë të kemi sukses në fushën e parandalimit dhe nëse e marrim për bazë modelin analizues të procesit të radikalizimit të personave, atëherë është e domosdoshme të krijohen politika për secilin individ apo grup individësh në secilin kat të modelit “shkallët drejt terrorizmit”.

Në këtë drejtim është e nevojshme edhe përfshirja e filozofisë së policimit në bashkësi si një koncept demokratik i ndërveprimit dhe ngritjes së bashkëpunimit me qytetarë në të gjitha nivelet.

Qëllimi i përfshirjes së policimit në bashkësi dhe angazhimit të bashkësisë në identifikimin dhe parandalimin potencial të kërcënimeve që vijnë nga radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm do të ishte një ndihmesë jashtëzakonisht e vlefshme në aspektin e identifikimit të personave apo grupeve të cilët tashmë kanë filluar të ngjiten lartë në katet sipas modelit “shkallët drejt terrorizmit dhe krijimin e politikave të qasjes dhe bashkëveprimit me këta persona.

Kjo do të na mundësonte edhe identifikimin e personave të cilët potencialisht gjenden në katin e katërt apo katin e pestë të modelit “shkallët drejt terrorizmit” persona të cilët tashmë konsiderohet se kanë krijuar mendësinë NE kundër ATYRE dhe se të njëjtit kanë anashkaluar apo mënjanuar kufizimet psikologjike frenuese njerëzore dhe se janë në gjendje që në çdo moment të aplikojnë metoda dhe aktivitete të dhunshme me qëllim të arritjes së qëllimeve të tyre.

Kryesisht politikat afat shkurta do të hartoheshin për individët të cilët janë identifikuar si terroristë apo ata të cilët vetëm kanë marrë pjesë në luftërat e huaja duke iu bashkuar organizatave terroriste. Konsiderojmë se është më se e nevojshme që politikat afat gjata që krijohen duhet me doemos të trajtojnë dhe parandalojnë individët apo grupet e individëve që të ngjiten në katet e më larta se kati i tretë i modelit “shkallët drejt terrorizmit”.

## KAPITULLI II

### INDIKATORËT QË SHPIJNË NË RADIKALIZËM DHE EKSTREMIZËM TË DHUNSHËM

*Ky kapitull do të trajtojë disa nga shenjat e hershme  
dhe paralajmëruese të procesit të radikalizmit që  
potencialisht shpie në dhunë*



*Djali im ka qenë shumë i sjellshëm, i mençur dhe kurioz.  
Atij i ka pëlqyer gjithmonë të më ndihmojë mua dhe njerëzve të tjerë.  
Ai ka qenë djali im i madh.  
Por...gjithçka ka ndodhur shumë shpejt ... ai ndryshoi shokët dhe ambientin.  
Kam pasur shumë pak dyshime se ai mund të devijoj por që, asnjëherë nuk kam menduar se ai do të linte çdo gjë, të na linte neve si familje...  
Prej atëherë, jeta jonë ka ndryshuar komplet dhe  
Ne ende nuk mundemi të kuptojmë se çka ka ndikuar në ndryshimin e tij.*

**Rrëfimi i prindit të një djali të ri i cili ka shkuar të luftojë në Siri.**

# **NËSE VËRENI DIÇKA E DYSHIMTË, RAPORTOJE NË POLICINË E KOSOVËS 192**

Ndryshimi i sjelljes zakonisht hap mundësi debate dhe interpretimi. Për këtë arsye, është shumë me rëndësi të shikohet mënyra dhe shkalla e ndryshimit të sjellje. Prezenca e ndonjë nga indikatorët që identifikon dokumenti nuk do të thotë domosdoshmërisht aktivitet kriminal POR kjo e rritë mundësinë e prezencës dhe pranimit të indikatorëve të tjerë në faza të mëvonshme.

**TË GJITHË INDIKATORËT DUHET TË MERREN SERIOZISHT NË KËTË KONTEKST. ANDAJ, NËSE KENI DYSHIME TË TILLA PËR AKTIVITETE TË DYSHIMTA, MOS HEZITONI TË RAPORTONI!**

Në përgjithësi ideologjitë, motivet, bindjet politike dhe besimet religjioze mund të ndryshojnë nga individët apo grupet e individëve që tashmë gjenden në katin e katërt respektivisht në katin e pestë të modelit “shkallët drejt terrorizmit”, por terroristët e kanë një gjë të përbashkët – ata gjithmonë kalojnë nëpër fazat e radikalizimit dhe planifikojnë veprimet e tyre të dhunshme.

Nëpër të gjithë procesin e radikalizimit, indikatorë të ndryshëm mund të vërehen nga shoqëria, të afërmit apo nga ndonjë bashkëveprues. Kërcënimet për sigurinë kombëtare mund të vijnë në forma të ndryshme dhe se identifikimi i hershëm i tyre potencialisht është i mundur <sup>17</sup>.

Kjo mund të ndodhë nëse kemi një bashkëveprim të ngushtë dhe të sinqertë me anëtarët e bashkësisë dhe anëtarët e forumeve të sigurisë në nivel lokal. Forumet e sigurisë në infrastrukturën e sigurisë në Republikën e Kosovës duhet të luajnë një rol më aktiv duke e pasur parasysh përbërjen e tyre gjithëpërfshirëse. Pikërisht anëtarët e forumeve të sigurisë dhe shoqëria në përgjithësi në bashkëveprim dhe koordinim me zyrtarët policorë të caktuar me punë në sektorët policorë do të mund që të identifikojnë dhe shkëmbejnë informata të ndërsjella me qëllim të parandalimit të aktiviteteve të dyshimta që potencialisht dërgojnë në radikalizim dhe planifikim të aktiviteteve të dhunshme.


Duke u bazuar në ilustrimin nga doracaku i projektit TERRA <sup>18</sup> shohim se rol kryesor në identifikimin e personave dhe parandalimin e veprimeve të dhunshme kanë kryesisht anëtarët e familjes, bashkëqytetarët dhe shoqëria e ngushtë, mësimdhënësit dhe kontaktet e përditshme me personat e dyshuar për radikalizim potencial dhe veprime të dhunshme.

Për identifikimin dhe parandalimin e hershëm të personave për tu futur në procesin e radikalizimit në ilustrimin e mëposhtëm shohim se rol kanë edhe bashkësitë fetare, klubet sportive, policia, komuniteti i të rinjve, gazetarët dhe mediat.

<sup>17</sup> Terrorism and Violent Extremism Awareness Guide PS64-129/2016E-EPUB 978-0-660-03505-5, Canada

<sup>18</sup> TERRA Toolkit – Community Approach to Radicalization



Modeli gjithëpërfshirës:<sup>19</sup>

Gërshetimi i të gjithë këtyre akterëve të ilustruar në modelin gjithëpërfshirës dhe bashkëveprimet dhe koordinimi i aktiviteteve reciproke si dhe raportimi me kohë i kërcënimeve të kësaj natyre të krimin mund të bëjë ndryshime dhe të ofrojë një siguri për të gjithë. Është më se e nevojshme që të ngritet vetëdija e publikut në përgjithësi (familjeve, mësime dhënësve, shoqërisë, partnerëve të ndryshëm, komunitetit të biznesit, agjencive hoteliere etj) rreth rëndësisë së raportimit me kohë dhe parandalimit të pasojave të cilat potencialisht mund të jenë fatale për shoqërinë dhe sigurinë kombëtare.

Për të bërë përpjekje në parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm të gjithë akterët e përfshirë në modelin gjithëpërfshirës duhet të dinë dhe të kenë parasysh disa faktorë apo indikatorë që shpijnë individin për tu radikalizuar apo për të ndërmarrë veprime të dhunshme. Deri në radikalizim dhe ekstremizim të dhunshëm nuk do të thotë se niveli i ulët i edukimit luan rol kryesor, por ekzistojnë edhe faktorë të tjerë që potencialisht mund të kontribuojnë në radikalizimin e të rinjve.

<sup>19</sup> TERRA Toolkit – Community Approach to Radicalization

Në këtë drejtim mund të kontribuojë edhe kushtet e dobëta sociale dhe ekonomike, shkalla e psikologjisë dhe niveli i bindjes së individit dhe grupit, shkalla e lartë e papunësisë, problemet serioze familjare (në mes të familjes së ngushtë dhe të gjerë), etj.<sup>20</sup>

### **Specialistë të kësaj fushe këta lloj faktorësh që ndikojnë në procesin e radikalizmit i ndajnë në dy fusha kryesore:**

- **“Faktorët Shtytës”** e dërgojnë individin deri te ekstremizmi i dhunshëm si për shembull: margjinalizimi, pabarazia, diskriminimi, persekutimi apo të perceptuarit ndyshe nga të tjerët, qasja e kufizuar në edukim adekuat dhe cilësor, mohimi i të drejtave civile dhe ankesat mjedisore, historike, dhe socio ekonomike.

- **“Faktorët Tërheqës”** janë ushqim për kërkesat në ekstremizëm të dhunshëm për shembull: ekzistimi i grupit të ekstremistëve të dhunshëm të organizuar mirë, me një program të kompletuar dhe efikas për ofrimin e shërbimeve, dëmshpërblimeve, punësimit etj. Këto grupe ekstreme të dhunshme gjithashtu mund të joshin individët për t’iu përgjigjur ankesave të tyre duke ju premtuar dhe ofruar një rehati shpirtërore, një vend adekuat të cilit i takon dhe duke i ofruar një rrjet të mbështetjes sociale<sup>21</sup>.

### **Sipas udhëzuesit vetëdijesues të hartuar nga Royal Canadian Mounted Police, indikatorët e radikalizmit që shpijnë në veprime dhe aktivitete të dhunshme i ndajmë në dy grupe:<sup>22</sup>**

1. Indikatorët e radikalizmit që shpijnë në aktivitete të dhunshme dhe
2. Indikatorët e planifikimit të aktiviteteve terroriste – shenjat e hershme

<sup>20</sup> Davies, L. 2008. Educating Against Extremism: Towards a Critical Politicisation of Young People. *International Review of Education*, 55 (2/3), pp. 183-203. doi:10.1007/s11159-008-9126-8

<sup>21</sup> USAID, Summary of Factors Affecting Violent Extremism. [http://pdf.usaid.gov/pdf\\_docs/PBAAA929.pdf](http://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PBAAA929.pdf); Zeiger, S. and Aly, A. 2015. Countering violent extremism: developing an evidence-base for policy and practice. Curtin University, Hedayah.

<sup>22</sup> Terrorism and Violent Extremism Awareness Guide PS64-129/2016E-EPUB 978-0-660-03505-5, Canada p-31

## 1. INDIKATORËT E RADIKALIZMIT QË SHPIJNË NË AKTIVITETE TË DHUNSHME <sup>23</sup>

Sjelljet e dukshme dhe të monitorueshme në përgjithësi që kanë të bëjnë me procesin e radikalizmit deri tek përdorimi i dhunës karakterizohen kryesisht me:



Sjelljen



Dukjen



Zakoni



Marrëdhënien



Identitetin



Ideologjinë

### DISA NGA INDIKATORËT QË NDIKOJNË NË PROCESIN E RADIKALIZIMIT DERI NË VEPRIMET E DHUNSHME MUND TË JENË:

- Pranimi dhe arsyetimi i imazheve dhe videove propaganduese në internet dhe rrjete sociale me përmbajtje të dhunës dhe urrejtjes;
- Ndryshimi drastik i interesit;
- Prishja e lidhje familjare, izolimi shoqërorë, ndryshimi i shoqërisë dhe aktiviteteve (familja, sporti, shkolla etj.);
- Ndryshimi i mënyrës së të menduarit dhe komunikimit me të tjerët;
- Refuzimi i rregullave dhe vlerave shtetërore;
- pjesëmarrja në aktivitete radikale apo demonstrata të dhunshme duke përdorur gjuhë të urrejtjes dhe ekstreme;
- Pjesëmarrja në takime private/të fshehta që ndikojnë në ndryshime ideologjike;
- Posedimi i materialeve propaganduese që promovojnë dhunën (broshura, libra, video materiale, DVD, muzikë, web-faqe, rrjete sociale etj);
- Krijimi i ndarjeve dhe antagonizmit (NE kundër ATYRE);
- Të pranuarit normal të urrejtjes dhe dhunës;
- Lavdimi dhe promovimi i dhunës dhe sakrificës;

<sup>23</sup> Terrorism and Violent Extremism Awareness Guide PS64-129/2016E-EPUB 978-0-660-03505-5, Canada p-31

- Kryerja e aktiviteteve të vogla kriminale duke refuzuar rregullat e qeverisë dhe shoqërinë në përgjithësi;
- Ndryshimi në dukje dhe në stilin e veshjes;
- Përdorimi i emrave të ri apo pseudonimeve apo nofkave në rrjetet sociale dhe në ambiente të ndryshme.

## **RADIKALIZMI I DHUNSHËM I MUNDËSUAR NGA INTERNETI**

indikator dhe faktor i fuqishëm i radikalizmit tek të rinjtë

Më shumë se kurdoherë, sot të rinjtë e Kosovës por edhe më gjerë janë duke jetuar edhe jetën virtuale paralel me atë reale. Sot, interneti shfrytëzohet nga fëmijët dhe të rinjtë për arsye të ndryshme qofshin ato hulumtuese, edukuese, zbavitëse, rrjetëzimin me bashkëmoshatarët dhe personat e tjerë përmes rrjeteve sociale, dhe shumë shpesh interneti përdoret thjeshtë për të kaluar kohën e lirë, kohë kjo e cila nuk është shumë e vogël. Ky përdorim i internetit nga fëmijët dhe të rinjtë nuk ndodh vetëm në ambientet e shtëpisë por avancimi i teknologjisë dhe pajisjeve që kanë qasje në internet ju ka mundësuar atyre që internetin ta përdorin pothuajse kudo, në shkollë, bibliotekë, kateteri apo rrugë duke përdorur pajisje të avancuara dhe moderne siç janë telefonat e mençur me sistem operativ Android dhe IOS, tabletë, laptopë etj.

### **MË SHUMË TË KYÇUR (ONLINE) SE TË Ç'KYÇUR (OFFLINE)**

Dukuria e përdorimit masiv të internetit dhe rrjeteve sociale të komunikimit është bërë një përditshmëri e pashmangshme nga të rinjtë jo vetëm në Republikën e Kosovës por sipas statistikave zyrtare, ky shqetësim është prezent edhe në vendet e rajonit dhe Evropë në përgjithësi. Për të qenë më preciz në këtë drejtim, shqetësim nuk është përdorimi dhe shfrytëzimi i këtyre rrjeteve sociale për qëllime të edukimit, komunikimit apo informimit të drejtë por pikërisht keqpërdorimi, shantazhi dhe konfliktet që iniciohen përmes rrjeteve sociale është dukuri shqetësuese.

Duke i analizuar statistikat e rasteve të incidenteve në dhe përreth shkollave në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe duke pranuar


ankesa pothuajse në baza ditore nga mësimdhënësit dhe menaxhmentin i institucioneve para-universitare për problemet dhe sjelljet e dhunshme në mes të bashkëmoshatarëve, Policia e Republikës së Kosovës përmes Drejtorisë së Policimit në Bashkësi dhe Parandalim të Krimit duke e parë nivelin dhe trendin e sjelljeve delikuede dhe dhunës në institucionet e arsimit para-universitar në vend dhe me qëllim të identifikimit se në çfarë mase dhe cilat rrjete sociale përdoren nga të rinjtë, ka bërë një hulumtim me 1200 nxënës nga 8 shkolla fillore respektivisht 4 të mesme<sup>24</sup>.

Pyetëtori ka qenë i formuluar në 8 pyetje të thjeshta dhe të kuptueshme për nxënësit si respondentë. I gjithë procesi i hulumtimit ka qenë i koordinuar me Drejtorinë Komunale të Arsimit dhe me menaxhmentin e shkollave të cilët edhe kanë ndihmuar direkt në realizimin e hulumtimit.

Meqenëse në këtë doracak po flasim për nivelin e përdorimit dhe llojin e rrjeteve sociale nga të rinjtë tanë, neve do të ndajmë në këtë kapitull vetëm pyetjet që kanë të bëjnë me këtë fushë.

### Në pyetjen se: A shfrytëzoni rrjetet sociale të komunikimit?


Nga 1200 nxënës të përgjigjur në këtë pyetje, 720 prej tyre janë përgjigjur se shfrytëzojnë FACEBOOK-un, 247 prej tyre përdorin TWITTER-in, 127 përdorin INSTAGRAM-in dhe 66 prej tyre përdorin FACEBOOK MESSENGER.



<sup>24</sup> [http://www.kosovopolicice.com/repository/docs/Raport\\_mbi\\_t%C3%AB\\_gjeturat\\_nga\\_hulumtimi\\_i\\_realizuar\\_me\\_nx%C3%ABn%C3%ABs\\_t%C3%AB\\_shkollave\\_fillore\\_dhe\\_t%C3%AB\\_mesme\\_t%C3%AB\\_kryeqytetit\\_rreth\\_p%C3%ABrceptimit\\_t%C3%AB\\_siguris%C3%AB\\_n%C3%AB\\_shkolla.pdf](http://www.kosovopolicice.com/repository/docs/Raport_mbi_t%C3%AB_gjeturat_nga_hulumtimi_i_realizuar_me_nx%C3%ABn%C3%ABs_t%C3%AB_shkollave_fillore_dhe_t%C3%AB_mesme_t%C3%AB_kryeqytetit_rreth_p%C3%ABrceptimit_t%C3%AB_siguris%C3%AB_n%C3%AB_shkolla.pdf)

### Në pyetjen se: Për çka më shumë e shfrytëzoni internetin?

Nga 1200 nxënës të përgjigjur në këtë pyetje, 662 prej tyre janë përgjigjur se shfrytëzojnë internetin për komunikime me shoqërinë, 69 prej tyre përdorin për qëllime të hulumtimit, 73 përdorin për literaturë dhe edukim, 203 prej tyre përdorin internetin për të kaluar kohën e lirë dhe 193 prej tyre përdorin internetin për argëtim me lojëra online.



Nga ky hulumtim mund të shohim se të rinjtë në Kosovë janë njohës të mirë të kërkimit në internet dhe përdorues jashtëzakonisht të shumtë të rrjeteve sociale të komunikimit.

Por, përderisa interneti mundëson qasjen e fëmijëve dhe të rinjve në përvoja të shkëlqyera edukative, kënaqësi të jashtëzakonshme në fushën e argëtimit përmes lojërave të ndryshme 'online' dhe bashkëbisedimit në kohë reale me shokë dhe më gjerë, në të gjitha këto aktivitete ekziston edhe një numër i madh i rreziqeve që iu kanosen të rinjve, për të cilat jo vetëm fëmijët apo të rinjtë por edhe prindërit dhe qytetarët në përgjithësi duhet të kenë parasysh.

Tashmë janë të njohura disa kërcënime dhe rreziqe që iu kanosen të rinjve gjatë përdorimit internetit siç janë për shembull vjedhja e identitetit dhe shantazhimi, etiketimet dhe përqeshjet 'online' (në anglisht e njohur si 'online bullying'), mashtrimet 'online', e shumë rreziqe të tjera. Por,

krahas këtyre rreziqeve, ekziston një çështje tjetër shumë shqetësuese dhe kërcënim për të rinjtë, shqetësim ky të cilin duhet që në mënyrë kolektive ta adresojmë dhe parandalojmë. Fjala është për ndikimin e internetit tek të rinjtë për t'i radikalizuar dhe shpër në aktivitete të dhunshme.

Ky doracak shërben për të ndarë informata rreth rreziqeve që ballafaqohen të rinjtë në internet kur kemi të bëjmë me ndarjen e ideologjive ekstreme të cilat dërgojnë në radikalizëm dhe manifestim të aktiviteteve të dhunshme.

Radikalizmi i të rinjve nuk është një fenomen i ri në botë. Radikalizmi që shpie drejt dhunës nuk ka qenë dhe nuk do të jetë i kufizuar vetëm në shënjestrimin e individit apo grupit në aspektin religjioz, kulturor, etnik, nacionalist apo separatist. Grupet ekstremiste dhe terroriste brenda organizimit të tyre posedojnë individë me aftësi dhe shkathhtësi jashtëzakonisht të mira komunikuese dhe manipuluese që përdoren për shpërndarjen e ideologjive radikale dhe ekstreme duke shenjëstruar të rinjtë dhe promovuar propagandën “parajsën” për të rinjtë nëse bashkohen me ta dhe duke arsyetuar aktivitetet e dhunshme për arritjen e qëllimit. Së fundmi, ne kemi parë një kampanjë të pa parë deri më tani në internet të angazhimit të ekstremistëve dhe terroristëve me qëllim të ndryshimit të mendësisë së të rinjve, radikalizimin e tyre dhe rekrutimin e tyre qoftë duke iu bashkuar fizikisht organizatave terroriste apo duke u angazhuar për të kryer sulme në vendin e origjinës duke ndjekur udhëzimet e terroristëve.

Kjo lloj qasjeje e terroristëve për të kryer sulme në vendin apo shtëpinë e vet duke mos iu bashkuar atyre fizikisht quhet aktivitet i “ujqërve të vetmuar” në anglisht aktivitet i njohur si “lone wolvs”.

Synimi i terroristëve për të radikalizuar të rinjtë si individë apo grupe individësh realizohet atëherë kur mesazhi i tyre ‘online’ dërgohet nga ndonjë figurë apo personalitet i njohur qoftë përbrenda grupit terroristë apo edhe nga ndonjë klerik fetar, aktor, sportist apo të ngjashme dhe ky mesazh pranohet nga të rinjtë naiv dhe të pa informuar. Ky mesazh i pranuar nga ndonjë figurë apo personalitet i njohur do të pranohet më lehtë dhe më mirë nga të rinjtë sidomos kur ky mesazh propagandues

vjen nga ndonjë anëtarë i familjes, ndonjë shok i ngushtë, apo ndonjë person me ndikim në shoqëri i cili gëzon respekt tek të rinjtë. Mesazhe propaganduese dhe tërheqëse për të radikalizuar të rinjtë në ditët e sotme po kemi shumë e më shumë.

Duke e parë këtë situatë dhe aktivitet të madh 'online' të terroristëve, pa dyshim se interneti luan pothuajse rolin kryesor në radikalizimin e fëmijëve dhe të rinjve.

Interneti dhe faqet e ndryshme 'online' përfshirë edhe rrjetet sociale të komunikimit (FACEBOOK, TWITTER, INSTAGRAM, FB/MESSENGER, SNAPCHAT, kanali YOUTUBE) mund të kyçen të gjithë njerëzit, të rinjtë apo të moshuarit dhe se ndonjëherë edhe pa dashje linçe të ndryshme hapen në ekranet e tyre duke i ri-drejtuar ata në faqe me përmbajtje jo adekuate apo në të shumtën e rasteve edhe në ato që përmbajnë urrejtje dhe jo tolerancë fetare, etnike, kulturore, nacionaliste dhe separatiste. Për shumë individë dhe grupe individësh interneti shërben një mjet ideal për të komunikuar dhe shpërndarë mendësinë dhe potencialisht ideologji të ndryshme me përmbajtje të dhunshme.

Arsyeja pse këto grupe ekstreme përdorin pikërisht rrjetet sociale të komunikimit është mundësia për tu lidhur dhe krijuar 'shoqëri' me persona të panjohur dhe duke mos pasur asnjë interes të përbashkët. Vet platforma e rrjeteve sociale e mundëson këtë lloj rrjetëzimi me njerëz të shumtë qoftë përmes shokëve tuaj aktual apo edhe përmes interesave që potencialisht janë të përbashkëta.


FACEBOOK, TWITTER dhe rrjetet tjera mundësojnë që në mënyrë efektive, të shpejtë dhe pas asnjë filtrimi, të shpërndajnë ndonjë mesazh, video apo ndonjë ideologji e cila shumë shpejt mbërrin një numër të madh të lexuesve. Kur kemi parasysh këto mundësi që ofrojnë rrjetet sociale dhe interneti në përgjithësi, individët dhe grupet e radikalizuara të individëve shfrytëzojnë në mënyrë aktive me qëllim të mbjelljes së ideologjisë ekstreme tek të rinjtë dhe rekrutimin potencial të tyre në aktivitete të dhunshme për kauza të pa baza. Përderisa shfrytëzimi i internetit dhe rrjeteve sociale ka përparësi të shumta qoftë në rrjetëzim dhe komunikim, hulumtim dhe edukim, komercializëm dhe biznes



gjithashtu posedon edhe rreziqe shumë serioze sidomos për fëmijët dhe të rinjtë të cilët potencialisht në baza ditore iu ekspozohen dhe pranojnë apo shohin mesazhe, video dhe ideologji të dhunshme nga ekstremistë të natyrave të ndryshme.

Në këtë drejtim është më se e nevojshme dhe më rëndësi që në mënyre gjithëpërfshirëse shoqërore dhe institucionale të fokusohemi jo vetëm në parandalimin e radikalizmit në internet si një mjet shumë i përshtatshëm për terroristët por të edukojmë të rinjtë tanë për rreziqet që iu kanosen gjatë përdorimit të internetit dhe në të njëjtën kohë të identifikojmë idetë radikale dhe ekstreme që iu servohen të rinjve dhe bashkërisht të mundohemi t'i parandalojmë personat e vulnerabil apo të ndjeshëm në këtë temë.

**Modeli gjithëpërfshirës:** <sup>25</sup>



<sup>25</sup> TERRA Toolkit – Community Approach to Radicalization

## UJQËRIT E VETMUAR<sup>26</sup>

(lone wolvs)

Duke e pare zvogëlimin e mundësisë për të rekrutuar individë të radikalizuar dhe ekstremistë të dhunshëm në radhët e grupeve terroriste dhe gjithashtu paraqitja e vështirësive në bashkimin fizik me grupet ekstremiste, individë në kuadër të grupeve terroriste të cilët kanë shkathtësi dhe aftësi jashtëzakonisht të mira komunikuese dhe bindëse përdoren për të motivuar dhe shpërndarë ideologji ekstreme tek personat tashmë të radikalizuar për të kryer aktivitete të dhunshme në vendin e tyre. Kjo tashmë është edhe një sfidë relativisht e madhe për agjencitë e zbatimit të ligjit dhe shoqërinë në përgjithësi.

Kjo lloj qasje dhe strategji e individëve për të vepruar të vetëm e të cilët ndajnë ideologjinë e njëjtë me grupet terroriste është bërë shumë shqetësuese dhe trishtuese për shoqërinë për arsye se është shumë e vështirë që të ndalen apo parandalohen aktivitetet e dhunshme të këtyre personave.

Aktivitetet e dhunshme të kryera nga persona të vetëm tashmë në terminologjinë ndërkombëtare njihet si “lone wolvs” apo “ujqërit e vetmuar”. Qasja e ‘ujqërve të vetmuar’ nuk kërkon grup njerëzish apo organizatë për t’u inkuadruar, kjo do të thotë se nuk ka ndonjë lider të grupit i cili duhet arrestuar. Shqetësimi është se në të vërtetë çdo kush, në çdo vend dhe në çdo kohë mund të kryejë aktivitete të dhunshme me pasoja serioze për shoqërinë.

Dita ditës ‘ujqër të vetmuar’ janë duke u aktivizuar në mbarë botën, si për shembull sulmuesit në Maratonës në Boston të ShBA-ve kanë qenë pikërisht ‘ujqër të vetmuar’ dhe në fakt në bazë të hetimeve të realizuara ata nuk kanë qenë të ndërlidhur me ndonjë organizatë terroriste.

<sup>26</sup> MOGHADDAM, Fathali M. “The Staircase to Terrorism, A Psychological Exploration”, American Psychologist, 2005

Strategjia e 'ujqërve të vetmuar' është duke u bërë shumë serioze dhe e frikshme pikërisht për shkak të internetit dhe rrjeteve sociale të komunikimit. Siç e potencuam edhe më lartë, internet iu mundëson personave që të komunikojnë në kohë reale me shumë persona të tjerë. Dhe si rezultat personat potencialisht mund të bien pre e manipulimeve dhe infiltrimeve në doktrina dhe ideologji të dhunshme të cilat i arsyetojnë veprimet e dhunshme.

Me qëllim të identifikimit dhe parandalimit të personave që tentojnë të përdorin këtë strategji, është më se e nevojshme të kemi një angazhim dhe koordinim multi-institucional në shkëmbimin e informatave dhe çka është shumë me rëndësi vitale edhe përfshirja e anëtarëve të bashkësisë dhe forumeve të sigurisë në bashkësi.

Pikërisht, duke e ditur se të gjithë kriminelët dhe ekstremistët e dhunshëm jetojnë në bashkësitë dhe lagjet tona, lagje këto të cilat i përkasin sektorëve policorë, atëherë është shumë e vërtetë se filozofia e policimit në bashkësi dhe kontakti i përditshëm i zyrtarëve policorë me banorët lokal është strategjia më e dobishme në identifikimin e hershëm dhe parandalimin potencial të aktiviteteve që mund t'i kryejnë 'ujqërit e vetmuar'.

Kjo qasje e personave të vetëm për të realizuar aktivitete të dhunshme kundrejt popullsisë së pafajshme civile dhe institucioneve në përgjithësi mund të identifikohet dhe parandalohet vetëm me ngritjen dhe avancimin e qytetarisë aktive dhe ndryshimin e mendësisë shoqërore se vetëm duke raportuar sjelljet dhe aktivitetet e dyshimta në bashkësinë e tyre dhe duke bashkëpunuar me Policinë e Kosovës mund të kontribuojmë në ngritjen e sigurisë në bashkësi për individët dhe familjet në përgjithësi.

## PËRPPJEKJET DHE PLANIFIKIMET PËR T’U LARGUAR NGA VENDI<sup>27</sup>

*indikator që tregon qëllimin radikal dhe ekstrem*

Zakonisht personat që tashmë janë ndikuar nga grupet dhe individët me ideologji të dhunshme ekstreme tentojnë që dhe bëjnë përpjekje që këtë mendësi të pranuar ta materializojnë dhe manifestojnë mësimet në praktikë. Deri në këtë shkallë personit potencialisht i duhet të kalojë në procesin e radikalizimit të elaboruar sipas profesorit Fathali MOGHADDAM nga Universiteti “George Town”. Mirëpo nganjëherë ky proces mund t’i anashkalojë “shkallët drejt terrorizmit” dhe personat të radikalizohen edhe më shpejt duke kryer aktivitete të dhunshme brenda apo jashtë vendit.

Nëse personat tashmë të radikalizuar me ideologji ekstreme intensifikojnë bisedat rreth ‘padrejtësive’ që po bëhen në mbarë botën duke nënvizuar ndonjë bashkësi të veçantë qoftë ajo fetare, nacionaliste, separatiste apo kulturore, ata potencialisht do të bëhen gati për të planifikuar largimin potencial nga vendi i lindjes me qëllim të bashkimit me organizatat terroriste në mbrojtje të ‘kauzës’ së caktuar.

### **Indikatorët kryesorë për identifikimin e këtyre personave janë:**

- Diskutimi rreth çështjeve dhe aktiviteteve humanitare;
- Posedimi i shkathtësive të cilat do të ndihmonin ndonjë krizë humanitare;
- Diskutimi rreth fesë, sakrificës, mbrojtjes së njerëzve më të dobët, Tokës së Shenjtë etj;
- Shprehja e dëshirës për të udhëtuar;
- Interesimi për informata rreth nxjerrjes së pasaportës dhe regjimit të vizave për vende të caktuara;
- Blerja e biletës së aeroplanit;
- Kërkimi i parave tek anëtarët e familjes apo edhe tërheqja e të hollave nga llogaria bankare;

<sup>27</sup> Terrorism and Violent Extremism Awareness Guide PS64-129/2016E-EPUB 978-0-660-03505-5, Canada

- Kërkimi i huave nga shokët dhe miqtë personal dhe familjar;
- Ndryshimi në sjelljet financiare (grumbullimi dhe ruajtja e të hollave dhe mos shpenzimi)
- Shitja e gjërave personale apo edhe zbukurimeve familjare me qëllim të përfitimit të parave;
- Intensifikimi i komunikimit në rrjetet sociale me persona të pa njohur, persona nga vendet e krizës. (e gjithë ky aktivitet në mënyrë të fshehtë dhe gjatë natës);
- Nganjëherë edhe vendosja e ndonjë statusi në rrjete sociale se si ndihet rreth situatës në ndonjë vend të caktuar dhe dhembshurisë që ndien për njerëzit e pafajshëm dhe të pambrojtur;
- Diskutimi rreth teorive konspirative dhe dominimit botërorë (arsyetimi i veprimeve të dhunshme).

## **2.INDIKATORËT E PLANIFIKIMIT TË AKTIVITETEVE TË DHUNSHME TERRORISTE - SHENJAT E HERSHME <sup>28</sup>**

Njeri është e pa mundur që në mënyrë të përkryer të planifikojë apo edhe të realizojë aktivitete të dhunshme pa u vënë re nga ndokush gjatë fazës së planifikimit.

Planifikimi i ndonjë aktiviteti të dhunshëm terroristë potencialisht shpërfaqë indikatorë që mund të jenë të dukshëm përgjatë ditëve, javëve apo muajve para sulmit eventual. Për këtë arsye angazhimi dhe përfshirja e të gjithë shoqërisë në identifikimin dhe parandalimin e sulmeve terroriste Për këtë arsye angazhimi dhe përfshirja e të gjithë shoqërisë në identifikimin dhe parandalimin e sulmeve terroriste është qenësore.

Zbulimi i një apo më shumë indikatorëve në çfarëdo konteksti do të ndihmonte dhe do të kontribuonte në parandalimin e kërcënimit apo sulmit potencial terrorist.

Shtëpitë e rëndomta ku jeton edhe familja e planifikuesit të sulmit terroristë mund të përdoret në forma të ndryshme për të planifikuar sulmin. Këto planifikime mund të jenë të natyrës së ruajtjes së kemikaleve të rrezikshme, materialit propagandues dhe armatimit, apo një hapësirë e veçantë në shtëpi mund të përdoret për organizimin e takimeve koordinuese në mes të radikalistëve dhe ekstremistëve të dhunshëm që planifikojnë të sulmojnë.

Ekzistojnë indikatorë të dyshimit të cilët lehtë mund të zbulojnë planifikimin e aktiviteteve terroriste siç janë për shembull literatura me përmbajtje dhe nxitje radikale dhe dhunë, propaganda të ndryshme, pajisja me për tu dirigjuar nga distanca apo edhe kemikalë të rrezikshme për të prodhuar ndonjë bombë apo kërcënim serioz për shëndetin e qytetarëve.

<sup>28</sup> Terrorism and Violent Extremism Awareness Guide PS64-129/2016E-EPUB 978-0-660-03505-5, Canada

**INDIKATORËT QË E BËJNË NJË SHTËPI TË DYSHIMTË PËR PËRDORIM NGA TERRORISTËT JANË:**

- Ngritja e sigurisë (vëzhgimi);
- Dritare të mbuluara;
- Ndalimi i qasjes në këtë hapësirë për anëtarët e familjes, qiradhënësin apo edhe pastruesin;
- Numër i madh i njerëzve që vijnë e shkojnë nga ky lokacion;
- Aroma të pa zakonta;
- Zhurmë e pa zakon të në intervale të ndryshme kohore;
- Prezencë e materialeve të pa zakonta përreth hapësirës ;
- Lëvizje të shpeshta nga lokacioni në lokacione të tjera.

**DËSHMITË APO KARAKTERISTIKAT FIZIKE TË NJË AKTIVITETI PËR TË KRIJUAR NJË BOMBË:**

- Djegie të lëkurës nga kemikale të ndryshme apo vrima të shkaktuara nga acidi në veshmbathje;
- Plagë të dyshimta, gërvishtje në trup veçanërisht në gjymtyrë apo mungesë të ndonjë pjese të trupit;
- Kokë dhimbje kronike apo dhimbje të fytit të shkaktuara nga kemikalet e ndryshme;
- Ndryshimi i ngjyrës së flokëve (përdorimi i hidrogjenit për të krijuar mjete plasëse ndikon në ndryshimin apo çeljen e lehtë të ngjyrës së flokëve).

**INDIKATORËT E DALLUESHËM NË PLANIFIKIMIN E SULMIT TERRORIST:**

- Monitorimi i afërt i personelit të sigurisë (policisë);
- Marrja e shënimeve, fotografimi apo video incizimi i caqeve potenciale;
- Vëzhgimi i lokacioneve të shenjëstruara dhe sistemit të tyre të sigurisë;
- Identifikimi i rrejshëm dhe mashtrues si për shembull uniforma apo ndonjë qasje e autorizuar false;
- Testimi i sistemit të sigurisë për të parë se si do të reagojnë zyrtarët e policisë në rast të ndonjë incidenti (lëshimi i alarmit fals, lajmërimi fals etj);
- Përpjekjet për të hyrë në zona të kufizuara/ndaluara;

- Përpjekjet për tu pajisur me kartela që mundësojnë qasjen në zona të kufizuara/cakuarap;
- Mbajtja e shënimeve apo video incizimi për të kërkuar përgjegjësi ose për të arsyetuar veprimet e dhunshme;
- Nervozizëm;
- Përpjekje për të nxjerrë informacione (duke bërë pyetje të pa zakonta);
- Përpjekje për të përvetësuar shkathtësi dhe trajnime (përdorimin e armëve, dronëve, “paintball” etj);
- Përpjekjet për të gjetur fonde pvr të financuar aktivitetet (përmes fondacioneve, mashtrimeve etj);
- Vizita faqeve të ndryshme në internet dhe duke hulumtuar caqe potenciale për sulm.





## KAPITULLI III

### ROLI I ZYRTARËVE POLICORË NË PARANDALIMIN E RADIKALIZMIT DHE EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

*Ky kapitull do të përmbajë njohuri rreth  
filozofisë së policimit në bashkësi dhe  
ndërlidhja me policimin e udhëhequr nga inteligjenca,  
udhëzime dhe këshilla për zyrtarët policorë në vijën e parë  
të përgjigjes në raste që kanë të bëjnë me  
radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm*



## FILOZOFIA E POLICIMIT NË BASHKËSI <sup>29</sup>

Policimi në bashkësi në të shumtën e rasteve njihet si një zhvillim efektiv i punës policore në mbarë botën. Mirëpo është me të vërtetë e vështirë që policimi në bashkësi të definohet me një përkufizim unik sepse shumë persona këtë koncept e kuptojnë me përkufizime të ndryshme e që kur të analizohen të gjitha këto përkufizime shihet se janë të njëjta. Shumë përkufizime policimin në bashkësi e nënvizojnë si punë policore apo aktivitet policorë në partneritet me bashkësinë me qëllim të identifikimit të problemeve dhe zgjidhjes së tyre.

### Çka është policimi në bashkësi?

Për shumë njerëz koncepti i policimit në bashkësi nënkupton shumë në aspektin e ngritjes së sigurisë ndërsa për të tjerët ndoshta për shkak të mos kuptimit të drejtë ky koncept nuk ka shumë domethënie. Nuk kam ndonjë qëllim që të imponoj ndonjë përkufizim personal sa i përket policimit në bashkësi mirëpo, unë do të bëjë disa sugjerime praktike dhe të logjikshme. Meqenëse fjala “policim” nuk ekziston në fjalorin e gjuhës shqipe, do të përpiqem të sqarojmë këtë term në mënyrë që ta kuptojmë më lehtë. “Policing” nga gjuha angleze do të thotë punë policore ose aktivitet policorë ose veprimtari policore. Ndërsa “Community policing” apo Policimi në Bashkësi do të thotë aktivitete policore në bashkësi. Tani, ky lloj koncepti dallon shumë nga konceptet policore në të kaluarën apo para 10 viteve.

Duhet të bëhen dallime nga koncepti tradicional i policimit dhe koncepti demokratik i policimit në bashkësi. Ju e dini se, policimi tradicional funksiononte duke ndërmarrë aktivitetet policore tek rastet të cilat tashmë kanë ndodhur, çoftë rastet e krimeve të ndryshme, dukurive negative, kundërvajtjeve në trafik etj. Përmes policimit demokratik në bashkësi, policia nuk shihet si akteri i vetëm në çështjet e sigurisë mirëpo rol, kontribut dhe përgjegjësi në ngritjen e sigurisë në bashkësi përmes parandalimit kanë edhe anëtarët e bashkësisë dhe institucionet tjera përmes bashkëpunimit me policinë.

<sup>29</sup> [http://www.kosovopolic.com/repository/docs/Mbrojttesi\\_nr.6\\_shqip.pdf](http://www.kosovopolic.com/repository/docs/Mbrojttesi_nr.6_shqip.pdf)


Qëllimi i këtij koncepti është që të stimulohen qytetarët për një qytetari aktive për të përmirësuar sigurinë në bashkësi duke u bërë më aktiv dhe përgjegjës në raportim të dukurive negative dhe krimeve të ndryshme. Për më tepër misioni i këtij koncepti është që të ngritë kënaqësinë e qytetarëve me shërbimet e policisë, të zvogëlojë frikën nga krimi për anëtarët e bashkësisë, të zvogëlojë nivelin e krimeve dhe sjelljeve jo shoqërore në bashkësi, të ngritë angazhimet e bashkësisë në zgjidhjen e problemeve lokale, të avancojë angazhimin punën e zyrtarëve policorë në aktivitetet policore dhe të rritë motivimin e zyrtarëve policorë përmes përmirësimit të kushteve dhe njohjes së punës.

Qëllim tjetër i këtij koncepti është pa dyshim edhe përpjekja për të ndryshuar mentalitetin jo vetëm brenda organizatës por edhe tek anëtarët e bashkësisë në veçanti. Bashkërisht duhet të punojmë shumë që secili nga ne, individualisht të kuptojmë drejt këtë koncept dhe më pas ta komunikojmë atë tek bashkësia dhe institucionet tjera të vendit.

Duhet të ju bëjmë me dije të gjithë qytetarëve se nëse nuk jeni ballafaquar direkt me ndonjë problem apo jeni dëshmitarë të kryerjes së ndonjë krimi apo kundërvajtje, nuk do të thotë që ju nuk keni obligim për të raportuar.

Pikërisht, raportimi i shkelësve dhe ndërmarrja e masave ndaj tyre qofshin ato parandaluese apo ndëshkuese për veprime apo mos veprime do të përmirësojë mirëqenien dhe kualitetin e jetës në aspektin e sigurisë për të gjithë anëtarët e bashkësisë.

Policimi demokratik është një koncept shumë më i avancuar i cili kryesisht fokusohet në parandalimin e krimit dhe dukurive negative në shoqëri si dhe në vete përmban disa elemente: - **Transformimin organizativ**; - **Ndërtimin e partneritetit dhe** - **Zgjidhjen e problemit**<sup>30</sup>.



<sup>30</sup> Strategjia dhe Plani i Veprimit 2017-2021 "Policimi në bashkësi" [http://www.kosovopolic.com/repository/docs/1.\\_Strategjia\\_dhe\\_Plani\\_i\\_Veprimit\\_2017-2021\\_-\\_Policimi\\_n%C3%AB\\_Bashk%C3%ABsi\\_.pdf](http://www.kosovopolic.com/repository/docs/1._Strategjia_dhe_Plani_i_Veprimit_2017-2021_-_Policimi_n%C3%AB_Bashk%C3%ABsi_.pdf)


**TRANSFORMIMI ORGANIZATIV** brenda konceptit të policimit në bashkësi nënkupton avancimin dhe adaptimin e organizatës policore, strukturimin dhe ngritjen e efektivitetit të sistemit informative me qëllim të mbështetjes së partneritetit me bashkësinë dhe zgjidhjes pro-aktive të problemeve.

Për më tepër ky element përmban: - Ndryshimin e mentalitetit brenda organizatës; - Përmirësimin e marrëdhënieve dhe kushteve të punës; - Planifikimi strategjik; - De-centralizimi i përgjegjësisë dhe vendim marrjes - Transparenca dhe llogaridhënia për kualitet dhe rezultat të punës; - Ndarja sektoriale; - Politikat; - Specializimi i zyrtarëve policorë në fusha të caktuara; - Burimet njerëzore dhe financat; - Përzgjedhja meritore e zyrtarëve me punë në sektorë me shkathtësi të mira komunikuese; - Vlerësimet reale, njohja e punës dhe motivimi i zyrtarëve policorë; - Organizimi i trajnimeve; - Avancimi i sistemit të teknologjisë informative konform konceptit të policimit në bashkësi.

Në kuadër të transformimit organizativ si element i konceptit të policimit në bashkësi , me qëllim të ofrimit me qytetarë dhe shkëmbimit të informatave në mënyrë reciproke, Policia e Kosovës pas analizave të situatës së sigurisë në stacionet policore duke përfshirë nivelin dhe trendin e krimit, objektet me rëndësi të veçantë, infrastrukturën e komunikacionit rrugorë, aspektet gjeografike të territorit të stacionit policorë, demografinë e popullsisë në atë zonë etj. ka krijuar të ashtuquajturit Sektorë Policorë.

Përmes ndarjes sektoriale synohet ngritja e nivelit funksional dhe punës në përgjithësi brenda zonës së përgjegjësisë (sektorit) me qëllimin e ofrimit të shërbimeve sa më afër qytetarëve dhe ngritjes së ndjenjës së sigurisë së tyre.

Sektori Policor nënkupton një pjesë të caktuar të një territori, brenda kufijve të një apo me shumë bashkësive lokale në territorin e Komunës, në të cilin një numër i caktuar i zyrtarëve policor kryejnë të gjitha veprimtarit policore lidhur me sigurinë e përgjithshme të komunitetit.



Organizimet dhe ndarja sektoriale e policisë patrulluese ka për qëllim të adresoj zgjidhjen e problemeve të qytetarëve dhe përfshirjen e tyre, ngritjen e besimit dhe krijimin e një lidhje më të drejtpërdrejtë me qytetarët, por edhe të zyrtarëve policor me zona të caktuara.

**DISA NGA KARAKTERISTIKAT PËR NJË NDARJE SEKTORIALE JANË:**

- Dukuritë negative dhe shkalla e rrezikshmërisë së jetës, mirëqenës dhe pronës së qytetarëve, shoqërisë, dhe rrezikshmërisë së pronës
- Numri i objekteve vitale me dedikim publik, politik, ekonomik, shtetëror, historik, fetar etj;
- Karakteristikat territoriale pozita gjeografike dhe rëndësia e tyre nga niveli i sigurisë;
- Shkalla e urbanizimit dhe e zhvillimit ekonomik dhe industrial;
- Niveli i zhvillimit të komunikacionit dhe turizmit,
- Faktori demografik,
- Faktori etnik dhe religjioz etj.

Në kuadër të ndarjes sektoriale policore është paraparë që çdo sektorë të posedojë edhe Evidencës Sektoriale e cila në baza ditore plotësohet dhe azhurnohet me informata të sakta nga terreni.

**DISA NGA ELEMENTET QË DUHET TË PËRMBAJË EVIDENCA SEKTORIALE POLICORE JANË:**

- Pozita gjeografike e sektorit;
- Evidencë mbi popullsinë në sektor;
- Evidencë mbi krimit në nivel sektori;
- Evidencë mbi personat potencialisht të radikalizuar apo të liruar nga burgu të dënuar si luftëtarë të huaj;
- Evidencë mbi komunikimin dhe bashkëpunimin me komunitetin;
- Evidencë për komunikim të brendshëm me stafin e PK-ës nga ai lokal deri ne nivel qendror.

Elementet e lartpërmendura nuk janë po themi kushtimisht elemente që shfrytëzohen nga të gjithë sektorët policorë, sepse në këtë rast policimit në bashkësi është koncept dinamik dhe ndryshon nga një stacion në tjetër gjegjësisht nga një sektor policor në një tjetër.



**DETYRAT KRYESORE TË SEKTORËVE POLICORË JANË TË BAZUARA NË LIGJIN PËR POLICINË DHE LIGJET A APLIKUARA NË REPUBLIKËN E KOSOVËS SIÇ JANË:**


- Parandalimi dhe luftimi i krimit;
- Identifikimi i recidivistëve të krimit;
- Detyrat në ruajtjen e rendit publik;
- Siguria e trafikut rrugorë;
- Detyrat dhe veprimet në përkrahje të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore, etj.

Me qëllim të organizimit më të mirë të bashkësisë, avancimit të komunikimit me qytetarë dhe ndërtimit të një partneriteti efikas i cili funksionon në ndarjen reciproke të informatave, Policia e Kosovës duke u bazuar në Ligjin mbi Policinë, Neni 7 gjejjësisht paragrafi 7.5 deri më tani më vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës ka themeluar 58 Komitete Lokale për Siguri Publike (KLSP) në gjithsej 58 sektorë policorë.

Komitetet Lokale për Siguri Publike janë trupa vullnetarë të cilët funksionojnë brenda një sektori policorë dhe të cilat kanë një përbërje të shumëllojshme të pjesëmarrjes apo anëtarësisë e të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë përmes iniciativave dhe projekteve të ndryshme ndikojnë në përmirësimin e kualitetit të jetës përmes përmirësimit të sigurisë në bashkësi.

Është dëshmuar që themelimi i këtij forumi të sigurisë ka ndikuar në organizimin e qytetarëve në fushën e sigurisë në bashkësi si dhe ka ngritur aktivitetet bashkëpunuese në mes të policisë dhe anëtarëve të KLSP-së në fushën e parandalimit të rasteve të ndryshme kriminale dhe dukurive negative të cilat mund të ndodhin në bashkësi.

Synojmë që të paktën në secilin prej 144 sektorëve policorë në tërë territorin e Republikës së Kosovës të themelohet nga një forum i tillë i sigurisë.



**Ky forum i sigurisë mund të iniciohet për themelim në dy mënyra:**<sup>31</sup>

1. Kur qytetarët me vet iniciativë dëshirojnë të organizohen më mire në identifikimin dhe adresimin e problemeve si dhe në ngritjen e cilësisë së bashkëpunimit dhe komunikimit me policinë. Qytetarët në këtë rast bëjnë kërkesë me shkrim tek komandanti i stacionit policor në zonën e tyre të përgjegjësisë, ky i fundit e aprovon kërkesën e bashkësisë dhe e përcjell përmes zinxhirit komandues deri tek Drejtori i Përgjithshëm për aprovim.

2. Ku komandanti i stacionit policor në bazë të analizave të sigurisë në zonën e përgjegjësisë, në bazë të rasteve të raportuara dhe raporteve nga terrene, në mënyrë që të ngritë bashkëpunimin dhe komunikimin me anëtarët e bashkësisë, në konsultim dhe dakordim të plotë me bashkësinë parashtron kërkesë përmes zinxhirit komandues deri tek Drejtori i Përgjithshëm për aprovim. Roli i Policisë së Kosovës në KLSP është mjaft i rëndësishëm dhe jetik. Çdo KLSP ka përfaqësuesit e policisë të cilët rregullisht marrin pjesë në takimet e organizuara dhe të drejtuara nga kryesuesit e KLSP-ve në të cilat shkëmbehen informata, shqetësime të banorëve dhe në të njëjtën kohë avancohet bashkëpunimi dhe komunikimi me qytetarë.

<sup>31</sup> Kushtet e përgjithshme për themelimin dhe funksionimin e Komiteteve Lokale për Siguri Publike

## QËLLIMI I KLSP-ve:

Qëllimi i KLSP-ve është që t'u ofroj bashkësive lokale mundësinë e ngritjes së zërit në policimin e zonave të tyre, të jenë organe konsultative në fushën e krimit, dhe sigurisë duke identifikuar çështjet; zhvillimin dhe implementimin e projekteve efektive për të adresuar këto çështje në nivel lokal në një marrëdhënie të ngushtë pune me autoritetet komunale, bashkësitë lokale dhe policinë.

KLSP kanë një rol të rëndësishëm për të luajtur në të 'lidhurit' - vertikalisht dhe horizontalisht - të institucioneve dhe qytetarëve të Kosovës në një infrastrukturë të sigurisë në bashkësi.

Ideja e KLSP është që të zhvillojë marrëdhëniet e reja ekzistuese dhe mbështetjen mes anëtarëve të bashkësisë, përfaqësuesve të komunës dhe policisë, duke krijuar forume të shumta për ndërveprim dhe përfshirje. Premisa është që njerëzit që punojnë së bashku drejt një qëllimi të përbashkët, do të rritet për të respektuar dhe besuar njëri-tjetrit, duke ndërtuar një themel të fortë për të adresuar shqetësimet e përbashkëta dhe për të zgjidhur problemet lokale.

Rezultatet e dëshiruara të këtij bashkëveprimi të bashkësisë janë reduktimi i krimit dhe përmirësimi i jetesës dhe sigurisë në bashkësi.

Subjekt i marrëdhëniet ndëretnike mbetet një çështje e ngutshme dhe e ndjeshme. Një nga pritjet fillestare në fillim të programit të policimit në bashkësi ishte se KLSP do të ofrojë një forum për komunikim dhe dialog ndëretnik.

Ka pasur një numër projektsh nëpërmjet të cilave KLSP-të kanë kërkuar në mënyrë eksplicite për të përmirësuar këto marrëdhënie, por mjaft shpesh një ndikim është krijuar edhe si një nënprodukt i projekteve që kanë kërkuar për të arritur qëllimet më diskrete apo të prekshme, të tilla si pastërtia e mjedisit.

**FAZAT E PROGRAMIT TRAJNUES TË KLSP- VE:**

Faza 1: Zgjedhja e Bashkësisë

Faza 2: Vizitat dhe Mbledhjet e Bashkësisë

Faza 3: Trajnimet

(Orientues, Partneriteti dhe Formimi i Ekipit, Zgjedhja e Problemit)

Faza 4: Konsultimet dhe përcjellja e punëve

Faza 5: Ndërtimi i kapaciteteve i Trajnimi i Trajnerëve

Faza 6: Trajnimet në vazhdimësi dhe ato përcjellëse për qëndrueshmërinë e tyre

Faza 7: Këshilli Ekzekutiv i KLSP-ve

Për më tepër, rreth angazhimit dhe profesionalizmit në kryerjen e detyrave vullnetare, janë hartuar edhe Kushtet e Përgjithshme të Komiteteve Lokale për Siguri Publike të cilat mund të shfletohen në web-faqen e Policisë së Kosovës.

**KËSHILLI EKZEKUTIV I KLSP-VE:**

Për të siguruar komunikimin e rregullt në mes të KLSP -ve në gjithë Kosovën.

Këshilli Ekzekutiv i KLSP-ve, është një platformë e shkëlqyer që i ndihmon të gjithë KLSP-të ekzistuese dhe të sapo krijuara për të shkëmbyer informacione në lidhje me aktivitetet e tyre, projektet dhe sfidat, si dhe për të zhvilluar strategji të përbashkëta për të adresuar problemet e tyre të përbashkëta.

Për të siguruar qëndrueshmërinë, Këshilli Ekzekutiv organizohet dhe mundësohet nga anëtarët KLSP-së, me caktimin e vendit të takimit të radhës nëpër bashkësitë KLSP-ve.

Mbledhjet e Këshillit Ekzekutiv (KE)-së janë të organizuar në baza tremujore. Në këtë takim ftohen përfaqësues nga organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare me qëllim të përfitimit të ndonjë donacioni në përkrahje të projekteve që hartojnë KLSP-të.

Në Republikën e Kosovës, në bazë të Strategjisë Nacionale për Siguri në Bashkësi 2011-2016, funksionojnë edhe forumet e sigurisë si:

**KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKS) dhe**

**EKIPI VEPRUES PËR SIGURI NË BASHKËSI (EVS).**

## KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI - KKSBB - <sup>32-33</sup>

Këshillat për Siguri në Bashkësi janë kategori të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Megjithëse Policia e Kosovës mban përgjegjësinë për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, ajo "lehtëson bashkëpunimin me autoritetet komunale dhe udhëheqësit e bashkësive përmes themelimit të Këshillave Lokale, sikur është rregulluar me ligj". Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi është një organ këshillues i kryesuar nga kryetari i komunës dhe anëtarë që janë përfaqësues të të gjitha komuniteteve përbrenda komunës". Qëllimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi është që ta "zhvilloj vetëdijesimin lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitetin lokal, t'i identifikoj brengat lidhur me sigurinë publike dhe t'i rekomandoj planet e veprimit, për t'i adresuar këto brenga me përpjekje bashkëpunuese të autoriteteve komunale, komuniteteve lokale dhe policisë.

Ministri i Punëve të Brendshme dhe Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal Në mbështetje të nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L- 076 për Policinë, nenit 8, paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, dhe nenit 38, paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011, nxjerrin: UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 27/2012 MPB - 03/2012 MAPL PËR KËSHILLAT KOMUNALE PËR SIGURI NË BASHKËSI  
Neni 1

Më këtë udhëzim administrativ përcaktohet mënyra e themelimit, përbërja, objektivat, detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi në secilën komunë të Republikës së Kosovës, si dhe rregullimi i mënyrës së funksionimit të tyre.

Çdo komunë është e obliguar të themeloj Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi. KKSBB themelohet me vendim të Kuvendit të komunës dhe kryesohet nga Kryetari i Komunës.

Në rast të mungesës së kryetarit, KKSBB kryesohet nga zëvendës kryetari i komunës përkatëse.

<sup>31</sup> MANUAL - Roli i KKSBB-ve - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal -MAPL-


<sup>32</sup> UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 27/2012 MPB - 03/2012 MAPL PËR KËSHILLAT KOMUNALE PËR SIGURI NË BASHKËSI Neni 1

Mandati i KKSBS-së është 4 vite dhe korrespondon me periudhën e mandatit të anëtarëve të Kuvendit të Komunës. Në çdo komunë, kryetari i komunës duhet të caktoj një zyrtar përgjegjës për administrimin e punëve të KKSBS-së (Koordinatorin).

Përbërja e KKSBS-së me sa vijon:

- 1.1. Kryetari i Komunës (Kryesues);
- 1.2. Komandanti i Stacionit të Policisë në komunën përkatëse;
- 1.3. Nga një përfaqësues legjitim i secilës bashkësi fetare të komunës përkatëse;
- 1.4. Nga një përfaqësues të secilit komunitet etnik të komunës përkatëse;
- 1.5. Kryesuesi i Komitetit për Komunitete të Kuvendit të Komunës;
- 1.6. Zyrtari për Barazi Gjinore;
- 1.7. Drejtori i Drejtorisë për Arsim;
- 1.8. Kryetari i Këshillit të Prindërve të Arsimit të Komunës përkatëse;
- 1.9. Një përfaqësues i FSK-së;
- 1.10. Një përfaqësues i secilit Këshill Lokal për Siguri Publike;
- 1.11. Kryesuesi i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi;
- 1.12. Një përfaqësues nga Sektori i Emergjencave Civile Komunale;
- 1.13. Përfaqësuesi i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim;
- 1.14. Një përfaqësues nga OJQ, mediat lokale, komuniteti i biznesit dhe komuniteti i personave me aftësi të kufizuara.

## PROCEDURA E THEMELIMIT TË KKSBS-së



**TAKIMET E KKSBSË:**

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi mban jo më pakë se 6 takime në vit, por nuk përjashtohet mundësia që të mbledhet edhe më shpesh, varësisht nga nevojat që dalin nga aktualiteti i kërkesave që paraqiten. Vendi ku ky Këshill mbledhet është ndërtesa e komunës, mirëpo në bazë pajtimit të shumicës së anëtarëve të KKSBSË, mbledhjet mund të mbahen edhe në ndonjë lokacion tjetër.

Për çdo mbledhje mbahet procesverbali, i cili i duhet të jetë i disponueshëm për anëtarët e Kuvendit të Komunës, një kopje e të cilit i dërgohet edhe Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Vendimet e KKSBSË miratohen më shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

**DETYRAT E ANËTARËVE TË KKSBSË**

Përbërja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi ofron mundësin për shtrirjen e gjërë të problemeve me të cilat mund të përballen qytetarët e komunave. E gjithë struktura e përfaqësuar mbulon fushat e ndryshme që lidhen me sigurinë publike dhe të cilat mund të adresohen për zgjidhje në institucionet përgjegjëse.

Për shembull, çështjet e emergjencave mund të zgjidhen bashkërisht në mes të institucioneve siç është: Komuna, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Forcës së Sigurisë, Policia dhe OJQ-të e ndryshme.

Pastaj, siguria në shkollë është temë e cila mund të prioritetizohet në nivelin lokal përmes koordinimit në mes të institucioneve si: shkollës, drejtorisë për arsim në komunë dhe policisë.

Duke marrë parasysh larminë e përfaqësimit institucional në KKSBS, rëndësia e këtij këshilli është mjaft e madhe në zgjidhjen e çështjeve të sigurisë publike.

Çdo përfaqësues (anëtarë) i KKSBSË duhet të parashtrij dhe të jap ide, plane, sugjerime dhe projekte konkrete për fushën përkatëse të cilën e mbulon dhe që ka të bëjë me ruajtjen apo përmirësimin e sigurisë në bashkësi. Kjo është detyra dhe obligimi kryesor të cilin janë thirrur për tu përfaqësuar anëtarët e KKSBSË.



## EKIPET VEPRUESE PËR SIGURI NË BASHKËSI - EVSB<sup>34</sup>

Një pjesë e fuqisë së një shoqërie qëndron tek gatishmëria e qytetarëve që të bëjnë ndryshim. Programi i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi (EVSB) krijon për qytetarët e vendit një ambient për t'u angazhuar në mënyrë konstruktive me institucionet për të adresuar dhe zgjidhur çështjet dhe brengat lokale. Departamenti i Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Programi Bilateral i Asistencës në trajnime për Hetime Penale (ICITAP) përmes programit të tij të Policimit në Bashkësi ka hartuar programin e EVSB-së në vitin 2003.

Së bashku me partnerët ndërkombëtar dhe një mori zyrtarësh vendorë, programi i EVSB-ve është dizajnuar që në mënyrë metodologjike të angazhojë dhe themelojë ekipet vullnetare nga bashkësia, policia dhe zyrtarë të qeverisë lokale për të punuar së bashku me qëllim që të identifikojnë, caktojnë prioritetet dhe të gjejnë zgjidhje të përbashkëta për problemet e sigurisë në bashkësi siç janë; krimi, siguria, liria e lëvizjes dhe jetesa.

Programi i EVSB-ve është i bazuar në parimet e Policisë në Bashkësi ku "policia është populli dhe populli është policia" dhe përpiqet të ndërtojë lidhje të reja dhe të mbështesë qeverisjen lokale.

Qytetarët të cilët punojnë së bashku drejt një qëllimi të përbashkët e zhvillojnë respektin dhe besimin ndaj njëri tjetrit duke ndërtuar një bazë të fuqishme dhe nga e cila sfidat e ndryshme lokale të sigurisë në bashkësi mund të adresohen së bashku.

### **PËRFITIMET JANË TË SHUMTA SI;**

- Vetëdije e ngritur ndaj çështjeve dhe brengave aktuale mbi sigurinë në bashkësi,
- Vetëdije e ngritur ndaj aktiviteteve të përbashkëta që përfshijnë bashkësinë, policinë dhe komunën,
- Role më të qartësuar të pjesëtarëve të shoqërisë në lidhje me reduktimin e krimit, ngritja e nivelit të sigurisë dhe përmirësimin e kushteve të jetës,
- Komunikim i përmirësuar me bashkësisë, policisë dhe komunës dhe
- Aftësi më të mira në zgjidhjen e problemit.


<sup>34</sup> <http://www.kosovopolic.com/sq/ekipet-vepruese-per-siguri-ne-bashkesi>



Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi punojnë ngushtë me zbatuesit e ligjit dhe me autoritetet komunale, dhe përdorin disa anëtarë të EVSB-ve mund të jenë shërbyes civil, një anëtarë i EVSB-së bën përpjekje dhe kontribuon në mënyrë vullnetare për të mirën e bashkësisë.

### -NDËRTIMI I PARTNERITETIT

nënkupton zhvillim të komunikimit të suksesshëm dhe efikas me qytetarë në mbledhjen e informative të cilat dërgojnë në identifikimin e problemeve në fazat e hershme të paraqitjes gjegjësisht para kryerjes së ndonjë krimi apo vepre tjetër të sanksionuar me ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës. Për të ndërtuar një partneritet të shëndoshë me qytetarë ne si zyrtarë policorë duhet që përveç mbledhjes së informatave, të aplikojmë edhe dhënien e informatës kthyesë për qytetarin nga




i cili kemi pranuar informatë për një rast të caktuar. Informata kthyesë jepet gjithmonë duke u konsultuar me shefin e sektorit dhe duke pasur kujdes që të mos zbulohen detajet e rastit të caktuar ku më pas do të vështirësonte procesin e hetimit.

Mirëpo, dhënia e informatës kthyesë tek qytetari do ta forconte edhe më shumë ndërtimin e partneritetit dhe se do të krijonte një ndjenjë tek qytetarë se informatën që ai ka dhënë ka rezultuar me rezultat konkret, do me thënë edhe ai ndien se ka kontribuar në zgjidhjen e një problem.

Duhet kuptuar se ndërtimi i partneritetit dhe koncepti i policimit në bashkësi i përket gjithë shoqërisë, individëve, institucioneve qeveritare dhe jo qeveritare, agjencive të ndryshme etj. Me qëllim të zbatimit të këtij koncepti ne duhet të ndërtojmë partneritet të shëndoshë edhe me institucionet e sipërpërmendura duke përfshirë bizneset, forumet e ndryshme rinore, mediat etj. Policimi në bashkësi aplikon apo fokusohet në një qasje pro-aktive në zgjidhjen e problemeve.

Para se policia të ndërvejojë në ndonjë rast i cili tash më ka ndodhur dhe pasoja është shkaktuar për qytetarin, ky koncept inkurajon anëtarët e bashkësisë, institucionet dhe organizatat e ndryshme që në mënyrë proaktive bashkërisht me policinë të zhvillojnë zgjidhje për problemet të cilat janë në fazat e hershme të shfaqjes.

**-ZGJIDHJA E PROBLEMIT** nënkupton bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve të bashkësisë me policinë fillimisht duke identifikuar problemin dhe shkaqet e tij, analizimin e problemit përmes trekëndëshit të problemit, përpilimin e përbashkët të planit të veprimit dhe ndarjen e roleve dhe zbatimin e tij si dhe pas përfundimit të rishikohet plani i veprimit dhe vlerësohet reagimi në mënyrë që të mësohet për ndonjë lëshim eventual. Procesi i zgjidhjes së problemit sipas modelit SARA dhe trekëndëshi i problemit është një strukturë e avancuar dhe e definuar mire për analizim të problemit apo krimit. Analizimi i problemit përmes të ashtuquajturit trekëndëshi i problemit lehtëson jashtëzakonisht punën për të përpiluar një plan të veprimit efektiv. Ky trekëndësh i problemit përbëhet nga tre elemente siç janë: Keqbërësi, Viktima dhe Vendndodhja. Duhet të kemi parasysh që nuk ekziston apo nuk mund të quhet problem apo krim nëse njëra nga këto elemente mundon në këtë trekëndësh. Në Britaninë e Madhe shpesh herë elementeve të këtij trekëndëshi i shtohet edhe elementi i katërt i cili ka të bëjë me kohën e kryerjes së problemit apo krimit, gjë që vetëm sa e pasuron analizimin profesional të problemit apo krimit.



## **ROLI I ZYRTARËVE POLICORË NË PARANDALIMIN E RADIKALIZMIT DHE EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM**

Zyrtarët policorë në stacione policore dhe sektorë policorë që janë në vijën e parë reaguese dhe ballafaqese me raste të ndryshme në bashkësi janë personeli i cili në mënyrë aktive mund të mbledhë informata nga anëtarët e bashkësisë. Këtë aktivitet policor e mundëson pikërisht ndarja e zonës së stacionit policor në zona më të vogla të quajtura sektorë policorë. Pikërisht nëse aplikohen parimet e filozofisë së policimit në bashkësi, zyrtarët policorë mund të kontribuojnë në parandalimin dhe evitim të potencial të aktiviteteve të dhunshme nga ekstremistë dhe persona tashmë të radikalizuar.

Kjo qasje policore kryesisht mundësohet përmes bashkëbisedimit në baza ditore me qytetarë që i përkasin zonës së përgjegjësisë së sektorit policor, duke filluar me përfaqësues të bizneseve (kafiterive, restoranteve etj.), përfaqësuesve të bashkësive fetare, menaxhmentin e shkollave fillore dhe të mesme, komunitetin e prindërve, pjesëmarrësit në komunikacionin rrugor etj.

Nga të gjithë këta akterë të përmendur, zyrtarët policorë mund të mbledhin informata të vlefshme për të identifikuar ndonjë aktivitet të dyshimtë, vepër penale apo edhe ndonjë person të radikalizuar me prirje ekstreme potencialisht të dhunshme.

Patrullimi si aspekt qenësor i policimit, bashkëbisedimi i rregullt i zyrtarëve policorë me qytetarë në kuadër të sektorit si dhe aplikimi i parimeve të filozofisë së policimit në bashkësi do të krijonte një prezencë të Policisë e cila do të ngritë sigurinë tek qytetarët dhe njëkohësisht do të forconte besueshmërinë për punën policore.

Një përparësi e zyrtarëve policorë të caktuar me punë në sektorët policorë është Procedura Standarde Operuese për sektorët policorë, e cila i mundëson një lloj autonomie shefit të sektorit që në bashkëpunim me stafin e tij të organizojë orarin e punës gjithmonë duke u bazuar në informatat paraprake nga qytetarët rreth ndonjë organizimi apo manifestimi në bashkësi.

**PËR SHEMBULL:**

*Nëse kemi informata se ta Mërkurën nga një grup i të rinjve do të organizohet ndonjë turnir në futboll, atëherë për të marrë pjesë në këtë aktivitet shefi i sektorit e diskuton mundësinë e përfshirjes së dy zyrtarëve policorë në rroba civile për të qenë pjesë e organizimit. Ky aktivizim i zyrtarëve policorë gjithmonë realizohet atëherë kur paraprakisht raportet e të rinjve me zyrtarët që do të marrin pjesë në turnir janë të shkëlqyera. Kjo do t'i mundësonte zyrtarëve policorë që të shoqërohem më shumë me të rinjtë dhe në të njëjtën kohë të bisedojnë tema të ndryshme që i preokupon ata dhe për probleme të natyrave të tjera.*

Gjithmonë zyrtarët e kyçur në kësi lloj aktivitetesh duhet të kenë parasysh që të mos insistojnë për të marrë informata për ndonjë problem apo person të caktuar dhe në asnjë rrethanë nuk duhet të zbulohen se gjatë bashkëbisedimeve me të rinjtë janë dukë mbledhur informata.

Avancimi i partneritetit me bashkësinë është një prej kushteve për të avancuar dhe ngritur nivelin e sigurisë në bashkësi dhe ballafaqimin në aspektin parandalues të dukurive negative dhe krimeve të llojeve të ndryshme. Ky aspekt i avancimit të partneritetit qartë parashihet edhe Strategjia dhe plani i veprimit 2017-2021 “policimit në bashkësi” në objektivin strategjik 1. fuqizimi dhe avancimi i partneritetit dhe 2. ngritja e besueshmërisë dhe kënaqshmërisë së publikut me punën policore.

Meqenëse zyrtarët policorë pothuajse në baza ditore kanë kontakte dhe takime me menaxhmentin e shkollave dhe me nxënësit varësisht nga trendi i problemeve në bashkësi dhe natyra e shfaqjes së tyre, zyrtarët policorë në bashkëpunim me menaxhmentin e shkollave mund të organizojnë debat apo ligjërata për nxënësit rreth identifikimit dhe parandalimit të problemeve të tilla.

Aktivitete të tilla zyrtarët policorë mund të organizojnë edhe me përfaqësuesit t bizneseve të cilat operojnë në zonën e tyre të përgjegjësisë.

Madje, përmes ideve kreative dhe projekteve që mund të paraqesin zyrtarët policorë në avancimin e sigurisë në bashkësi dhe krijimin e një mjedisi të siguritë për konsumatorët e bizneseve, edhe përfaqësuesit e bizneseve do të shprehin gatishmëri në mbështetjen e tyre.

#### **PËR SHEMBULL:**

*Në një takim të organizuar nga zyrtarët policorë me përfaqësuesit e bizneseve në sektorin e tyre, ata mund të prezantojnë situatën e sigurisë në sektorin e tyre për një periudhë të caktuar dhe të nënvizojnë apo listojnë problemet kryesore me të cilat ballafaqohen anëtarët e bashkësisë dhe rrezikohen bizneset apo konsumatorët e tyre. Nga kjo listë e problemeve, bashkërisht me përfaqësuesit e bizneseve ju mund t'i ndani problemet sipas prioriteteve dhe nevojës për reagim të menjëhershëm. Në këtë rast, të themi në mënyrë hipotetike se gjatë orëve të mbrëmjes në parkingun e njërit nga bizneset më të mëdha gati një javë rresht janë duke u thyer xhamat e veturave duke kërkuar ndonjë send me vlerë. Këto vjedhje tashmë janë shndërruar në një shqetësim për qytetarët dhe përfaqësuesit e biznesit. Me qëllim të parandalimit të vjedhjeve të tilla zyrtarët policorë të sektorit në bashkëpunim me përfaqësuesit e biznesit do të ftonin konsumatorët përmes informimit të tyre tek kasa që të marrin pjesë në një takim informues sa i përket shqetësimit të vjedhjeve të fundit. Paraprakisht, zyrtarët policorë do të pajtohen me përfaqësuesit e bizneseve se gjatë takimit nga zyrtarët policorë do të mbahet një ligjëratë me udhëzime dhe këshilla se si të mbrohen nga vjedhjet e tilla, do të shtojnë patrullimet gjatë orëve të mbrëmjes por që do të kërkojnë edhe nga përfaqësuesit e bizneseve që të mbështesin shtypjen e disa broshurave vetëdijesuese për qytetarët dhe të investojnë në instalimin e kamerave të sigurisë në disa pika kyçe në hapësirën e parkingut.*

Ky bashkëpunim do të pritej jashtëzakonisht mirë jo vetëm nga përfaqësuesit e bizneseve por edhe nga vet qytetarët dhe konsumatorët. Gjithashtu, kjo qasje policore do të ndikonte në ngritjen e besimit reciprok në aspektin e raportimit me kohë të rasteve të natyrave të ndryshme.

Policimi në bashkësi është një ndër konceptet më demokratike në aspektin e respektimit dhe mbrojtjes të të drejtave dhe lirive të njeriut por edhe në aspektin e identifikimit dhe parandalimit të dukurive të ndryshme negative që mund të ndodhin në bashkësi.

Pikërisht kjo filozofi e përveç që mundëson zgjerimin e partneritetit dhe transparencën e punës policore ndikon dhe kontribuon edhe në vetëdijesimin e qytetarëve rreth rëndësisë së raportimit dhe bashkëpunimit në fushë e sigurisë së përgjithshme.

Në këtë kontekst, zyrtarët policorë duhet të krijojnë raporte profesionale zyrtare në aspektin e bashkëpunimit reciprok edhe me të gjitha bashkësitë fetare në Republikën e Kosovës. Ky bashkëpunim do të mundësonte që të shkëmbehen informatat në fushën e sigurisë dhe shqetësimet potenciale që bashkësitë fetare mund t'i kenë.

Për më tepër, zyrtarët policorë do të informojnë në baza të rregullta përfaqësuesit fetarë me gjendjen e sigurisë në kuadër të zonës së sektorit policorë dhe njëherit do të kërkojnë bashkëpunim në parandalimin e veprave të ndryshme penale që hipotetikiht mund të ndodhin në atë sektorë. Përmes një bashkëpunimi të shëndoshë dhe të sinqertë në mes të zyrtarëve policorë dhe përfaqësuesve të bashkësive fetare në raste të caktuara për ndonjë shqetësim apo problem në bashkësi do të mund pikërisht të përdorej bashkëpunimi i tillë për të dërguar një mesazh tek praktikuesit e religjionit.

#### **PËR SHEMBULL:**

*Në një rrugë të caktuar në një nga sektorët policorë është një shkollë fillore me pothuajse 2000 nxënës. Kryesisht nxënësit janë të vegjël dhe se infrastruktura e shkollës është në atë mënyrë e konstruktuar që fëmijët të kenë qasje direkt në rrugën kryesore. Para tre ditëve, përpara shkollës një nxënës duke kaluar rrugën me bashkëmohatarë goditet nga një veturë e cila ka qenë me një shpejtësi të madhe. Fatmirësisht nxënësi ka shpëtuar me shumë pak lëndime trupore. Me qëllim të adresimit dhe parandalimit të problemit dhe fatalitetit potencial, zyrtarët policorë krahas bashkëpunimit me menaxhmentin e shkollës për të mbajtur një seri ligjëratash rreth sjelljes së nxënësve në komunikacionin rrugorë, ata kërkojnë nga përfaqësuesi fetar që gjatë riteve fetare të mbajë një ligjëratë për kujdesin e ngasësve të veturave gjatë afrimit afër shkollës së caktuar. Krahas këtyre aktiviteteve, zyrtarët policorë në mënyrë zyrtare dërgojnë kërkesë në kuoendin komunal që të merr masa në vendosjen e shenjave vertikale dhe horizontale të trafikut si dhe të vendosë disa mbrojtës përskaq trotuarit në mënyrë që fëmijët të pengohen nga qasja direkte në rrugë.*

Me këtë aktivitet të përshkruar, zyrtarët policorë do të vetëdijesonin nxënësit rreth sjelljeve të tyre në komunikacionin rrugorë dhe rreziqeve potenciale, përmes përfaqësuesit fetar do të shenjëstrohej një grup relativisht i madh i praktikuesve fetarë të cilët janë edhe ngasës të veturave që të kujdesen për shpejtësinë gjatë afrimit afër shkollës dhe komuna do të vendosë shenjat e trafikut dhe mbrojtësit në trotuar. Kjo do të ishte një iniciativë e cila do të shpëtonte jetë, do të vetëdijesonte pjesëmarrësit në komunikacion rrugorë dhe do të ngritë imazhin dhe besimin në Policinë e Kosovës.

Në përgjithësi zyrtarët policorë respektivisht stacionet dhe sektorët policorë konsiderohen si burimi më i madh i informatave me të cilat mund të shërbehen të gjitha njësitet hetuese në cilën do fushë qoftë.

Me qëllim të marrjes së informatave për aktivitete të dyshimta në bashkësi qofshin edhe ato aktivitete ekstremiste potencialisht të dhunshme, mbledhja e informatave nga qytetarët konsiderohet si burim primar dhe shume i vlefshëm në aspektin e identifikimit të ndonjë zone specifike apo më të ndjeshme për manifestimin e aktiviteteve kriminale.

Nëse zyrtarët policorë të sektorëve policorë tashmë kanë krijuar kontakte dhe besim reciprok me anëtarët e bashkësisë, atëherë pothuajse asnjë aktivitet i dyshimtë nuk mund të ndodhë pa pasur njohuri zyrtarët policorë. Për këtë arsye prezenca policore e përditshme dhe bashkëbisedimi me qytetarë dhe akterë të ndryshëm është primare në identifikimin e parandalimin e dukurive negative dhe krimeve të ndryshme.

Mirëpo, meqenëse stacionet policore në përgjithësi konsiderohet si burim primar i informatave, atëherë këto informata duhet të shkëmbehen edhe me njësitet e tjera policorë me qëllim të avancimit të hetimeve potenciale dhe sjelljen e rezultateve të suksesshme.

Krahas Strategjisë dhe planit të veprimit 2017-2021 “policimi në bashkësi”<sup>35</sup> e cila ka karakter të ndërtimit të partneritetit, besimit reciprok me qytetarë dhe mbledhjes së informatave, Policia e Kosovës ka hartuar edhe Strategjinë e Policimit të Udhëhequr nga Inteligjenca (PUI)<sup>36</sup> e cila kryesisht ka karakter të analizimit të informatave të pranuar nga policimi në bashkësi dhe prodhimin e produkteve inteligjente për drejtimin e operacioneve të ndryshme policore.

<sup>35</sup> Strategjia dhe Plani i Veprimit 2017-2021 “Policimi në bashkësi” [http://www.kosovopolic.com/repository/docs/1.\\_Strategjia\\_dhe\\_Plani\\_i\\_Veprimit\\_2017-2021\\_-\\_Policimi\\_n%C3%AB\\_Bashk%C3%ABsi\\_.pdf](http://www.kosovopolic.com/repository/docs/1._Strategjia_dhe_Plani_i_Veprimit_2017-2021_-_Policimi_n%C3%AB_Bashk%C3%ABsi_.pdf)

<sup>36</sup> Strategjia e Policimit të Udhëhequr nga Inteligjenca [http://www.kosovopolic.com/repository/docs/shqip\\_anglisht\\_serbisht\\_3.pdf](http://www.kosovopolic.com/repository/docs/shqip_anglisht_serbisht_3.pdf)



Policimi i Udhëhequr nga Inteligjenca futet në zhargonin policor diku rreth viteve 1990. Siç e potencon Gill në vitin 1998, origjina e PUI-së disi si e paqartë por në referencat e mëhershme thuhet se origjinën e ka nga Mbretëria e Bashkuar.

Edhe pse duke u bazuar në mundësitë që vetëm me një shtypje në tastierë të shpërndajmë ide kreative dhe inovative rreth PUI-së, ende mbetet mungesë e njohurive dhe kuptimit për shumë anëtarë të organizatave për zbatimin e ligjit për atë se çka në të vërtetë është PUI dhe PB, çka synojmë të arrijmë me to dhe si është menduar të funksionojnë këto dy modele apo koncepte.

Tani më, PUI si term njihet gjithmbarshëm jo vetëm nga organizata policore por edhe më gjerë, por ende domethënia apo qartësia e qëllimit të këtij koncepti mungon.

#### **KATËR ELEMENTET QË DUHET TË KONCENTROHEMI JANË:**

- shenjëstrimi i keqbërësve;
- menaxhimi i krimit dhe pikave ku ndodhin problemet në bashkësi;
- hetimi i një numri të krimeve dhe incidenteve; dhe
- aplikimi i masave parandaluese duke përfshirë punën me anëtarët lokal të bashkësisë për të zvogëluar krimin dhe çrregullimet tjera shoqërore në aspektin e sigurisë<sup>37</sup>.

<sup>37</sup> AUSTRALIAN INSTITUTE OF CRIMINOLOGY – Intelligence Led-Policing No: 248 ([http://www.aic.gov.au/media\\_library/publications/tandi\\_pdf/tandi248.pdf](http://www.aic.gov.au/media_library/publications/tandi_pdf/tandi248.pdf))



## POLICIMI NË BASHKËSI DHE NDËRLIDHJA ME POLICIMIN E UDHËHEQUR NGA INTELIGJENCA

### Çka është Informata Inteligjente?

Informata inteligjente mund të përkufizohet si një vlerë e shtuar, që rrjedh nga mbledhja, grumbullimi dhe procedimi i të gjitha informatave relevante lidhur me nevojat për palën, informata këto të cilat menjëherë apo potencialisht dërgojnë deri tek një vendim-marrje rreth klientit. Një këndvështrim më i gjerë rreth informatës inteligjente është se informata inteligjent është një strukturë, proces dhe produkt. Në shumicën e organizatave policore, njësia e inteligjencës apo sektori është i njohur brenda organizatës për posedim të njerëzve të organizuar, me shkathtësi, metoda dhe strukturë të mirë organizative<sup>38</sup>.

Informata inteligjente është informatë e cila potencialisht parandalon apo zbulon krime të llojeve të ndryshme. Zakonisht është informatë e cila analizohet me kujdes dhe bëhet vlerësimi i rrezikut. Të kuptosh dallimin nuk është e lehtë dhe shumë zyrtarë policorë ende kanë vështirësi të kuptojnë këtë dallim. Informatë është p.sh. numri apo krimet e kryera (sa gjoha të trafikut, sa të dyshuar janë arrestuar), ndërsa informatë inteligjente është informata e thjeshtë e cila kalon nëpër disa faza të vlerësimit dhe verifikimit ku në përfundim nga kjo informatë e thjeshtë kemi produkt inteligjent përmes të cilit parandalohet apo zgjidhjet një problem.

Policimi dikur ka qenë kryesisht një qasje re-aktive. Policia zakonisht iu ka përgjigjur thirrjeve apo rasteve të krimit, prishjes së rendit dhe qetësisë publike, aksidenteve të trafikut etj. Nëse informatat inteligjente nevojiteshin atëherë ato mblidheshin për t'iu përgjigjur kërkesave policore. Grupet kriminale, trafikantët, terroristët, kontrabanduesit dhe përdoruesit e drogës, hajdutët, dhunuesit, të gjithë jetojnë në bashkësitë tona. PUI do të thotë mbledhja e informatave inteligjente për të vazhduar më tutje me parandalimin dhe zgjidhjen e problemeve kështu që policimi në bashkësi do të ishte më shumë efikas dhe efektiv.

<sup>38</sup> AUSTRALIAN INSTITUTE OF CRIMINOLOGY - Intelligence Led-Policing ([http://www.aic.gov.au/media\\_library/publications/tandi\\_pdf/tandi248.pdf](http://www.aic.gov.au/media_library/publications/tandi_pdf/tandi248.pdf))

PUI nuk mund të funksionojë si duhet pa ndërlidhjen e ngushtë me Policimin në Bashkësi dhe anasjelltas. PUI është koncept që duhet të përqafohet apo të merret seriozisht nga të gjithë zyrtarët policorë e jo vetëm nga departamentet e specializuara.

### **TË MIRAT E POLICIMIT TË UDHËHEQUR NGA INTELIGJENCA**

Nëse koncepti i PUI-së do të kuptohej drejtë dhe zbatohet në mënyrë profesionale atëherë do të kishim efikasitet në punë dhe përfitime shumëdimensionale:

- Udhëzime më të qarta për patrullat policore;
- Vënia në cak e keqbërësve apo kundërvajtësve për zgjidhjen e problemeve dhe çështjeve të sigurisë publike;
- Puna efektive me partnerët;
- Zgjidhje më e shpejtë e problemeve në bashkësi;
- Përmirësimi i sigurisë në trafik;
- Menaxhimi më i mirë dhe vënia në prioritet e vendndodhjeve problematike;
- Udhëzon aktivitetet e policimit në bashkësi;
- Përmes PB, PUI ngritë të kuptuarit e kriminalitetit dhe çështjeve jo shoqërore në bashkësi;
- Zyrtarët policorë do të pranojnë detyra dhe direktiva të qarta.
- Kontribuon për PB në mbledhjen efektive, klasifikimin dhe regjistrimin e informatave
- Ofron mundësi hetuese dhe qasje pro-aktive për policët.
- Ofron shërbim më cilësor dhe të shpejtë për anëtarët e bashkësisë dhe do të ngritë besimin reciprok;
- Më shumë keqbërës do të sillen para drejtësisë;
- Tensionet dhe mosmarrëveshjet e bashkësisë do të menaxhohen dhe monitorohen në mënyrë efektive.
- PUI mbështet partneritetin me bashkësinë

“Gjërat e vogla” shumë shpesh dërgojnë apo mbështesin identifikimin e aktiviteteve kriminale të nivelit të lartë dhe se shumë aktivitete apo sjellje konsiderohen të nivelit të ulët por të cilat potencialisht kanë ndikim të madh në pasojat për anëtarët e bashkësisë dhe ndikojnë në pasigurinë në zonën e caktuar.

### NGA KUSH TË MBLIDHEN INFORMATAT PËR PUI-NË?

- Bashkëbisedimi me qytetarë;
- Raportimet e krimit/viktimat/dëshmitarët;
- Policia e trafikut rrugorë;
- Të arrestuarit/të paraburgosurit;
- Ndalesat dhe kontrollet rutinë;
- Angazhimi me shkollat, xhamitë, kishat, kafeteritë, klubet sportive, KKSB-të, KLSP-të, EVSB-të;
- Partnerët e ndryshëm në fushën e sigurisë publike;
- Takimet e ndryshme.

Kjo nuk është menduar të jetë vetëm një listë gjithëpërfshirëse por, vetëm disa ide për të stimuluar të menduarit rreth burimeve potenciale të cilat zyrtari policorë mund t’i përdorë gjatë aktiviteteve ditore të policimit për mbledhjen e informative. Kjo qasje e mbledhjes së informative nuk do të kuptonte vëzhgimin apo përgjimin siç ndoshta e bëjnë njësitet tjera të specializuara.

PUI është koncept ku zyrtarët policorë përdorin dhe mbledhin informata nga ajo se çka shohin dhe gjatë komunikimit me qytetarë. Ata duhet të njohin vlerën e veprimeve nga informata inteligjente dhe se çka të bëjnë me të.

PUI nuk kërkon nga zyrtarët policorë që të shkojnë tek njerëzit dhe të pyesin ata për informata të ndryshme. Zyrtarët policorë zhvillojnë në kontakt direkt me qytetarët në baza ditore duke nënkuptuar si pjesë të punës ditore policore në shërbim të qytetarëve. Ata duhet të njohin se çka është e rëndësishme dhe çka nuk është me qëllim që të kemi informata cilësore se sa sasiore. Zyrtarët policorë duhet të jenë në gjendje dhe të aftë që të qasen lehtësisht dhe të japin kontributin e tyre përmes informative të mbledhura në bazën e të dhënave, por puna e tyre është e zakonshme

dhe nuk ka nevojë për punë shtesë.

Mbledhja e informatave duhet të bëhet në mënyrë etike dhe në përputhje me të drejtat e njeriut që parasheh ligji në fuqi (e duhur, ligjore, llogaridhënese dhe e nevojshme).

**POLICIMI NË BASHKËSI DHE POLICIMI I UDHËHEQUR NGA INTELIGJENCA NUK DO TË THOTË:**

- Spiunimi i njerëzve apo bashkësive;
- Rrezikimi i integritetit dhe privatësisë personave të respektuar të bashkësisë;
- Angazhimi i zyrtarëve policorë me punë shtesë;
- Mbledhja e informatave vetëm sa për “sy e faqe” apo vetëm sa për të raportuar se kinse ka mbledhë informata.

Takimet informuese (brifingjet) janë një nga metodat kryesore me të cilat policët patrullues pajisen me informacionin që duhet të jetë efektivë. Takimet informuese duhet të përforcojë prioritetet lokale dhe kombëtare, duke përcjellë kërkesat e inteligjencës dhe të sigurojë në përditësimet inteligjencës.

Imagjinoni ndikimin që këta zyrtarë mund të ketë në prioritetet kombëtare ose lokale, nëse ata kalojnë një pjesë të kësaj kohe në mbështetje të këtyre prioritetëve, përmes patrullimeve në shënjestër të mbledhjes së informatave!?

Megjithatë, është e njohur se është shpesh rasti që kjo mund të menaxhohet vetëm nga njësitet e përkushtuara dhe ndonjëherë mund të jetë e vështirë për zyrtarët policorë të uniformuar.

Por takimet informuese mund dhe duhet gjithashtu të jenë më shumë rreth gjërave të cilat tanimë në mënyrë rutinë janë kaluar. Kjo përfshinë dërgimin e informatave inteligjente dhe raporteve të krimit tek njësia e ardhshme apo ndërrimi i ardhshëm dhe sigurimi që informatat e rëndësishme janë përditësuar dhe futur në sistem.

Policimi në bashkësi dhe Policimi i Udhëhequr nga Inteligjenca nuk do të thotë kthimi në sistemin komunist të policimit në bashkësi POR përmirësimin e nivelit të shërbimit ndaj qytetarëve dhe ngritjen e gatishmërisë së qytetarëve për të raportuar krimin dhe aktivitetet e dyshimta në bashkësi.

## REFERENCAT

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- Ligji i policisë;
- Strategjia dhe Plani i Veprimit 2017-2021 “Policimi në bashkësi”;
- Strategjia e Policimit të Udhëhequr nga Inteligjenca;
- Strategjia per Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshem dhe Radikalizimit që Shpie në Terrorizem - 2015-2020;
- Procedura Standarde Operuese e sektorëve policorë;
- Revista e Policisë “MBROJTËSI”
- BARTLETT, J Mr., BIRDWELL, J. Mr, KING, M. Mr “The edge of violence”;
- TERRA Toolkit – Community Approach to Radicalization;
- SMITH, Angus. “Radicalization - A Guide for the Perplexed”, Royal Canadian Mounted Police, 2009;
- “Radicalization 101”, International Association of Chiefs of Police, Committee on Terrorism, 2012;
- MOGHADDAM, Fathali M. “The Staircase to Terrorism, A Psychological Exploration”, American Psychologist, vol. 60, No 2, 2005;
- Terrorism and Violent Extremism Awareness Guide, Canada;
- Davies, L. 2008. Educating Against Extremism: Towards a Critical Politicisation of Young People. International Review of Education, 55 (2/3), pp. 183-203. doi:10.1007/s11159-008-9126-8;
- USAID, Summary of Factors Affecting Violent Extremism. [http://pdf.usaid.gov/pdf\\_docs/PBAAA929.pdf](http://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PBAAA929.pdf); Zeiger, S. and Aly, A. 2015. Countering violent extremism: developing an evidence-base for policy and practice. Curtin University, Hedayah;
- Terrorism and Violent Extremism Awareness Guide PS64-129/2016E-EPUB 978-0-660-03505-5, Canada p-31;

- Raporti mbi të gjeturat nga hulumtimi i realizuar në 8 shkolla rreth përdorimit të internetit dhe rrjeteve sociale nga të rinjtë
- MOGHADDAM, Fathali M. "The Staircase to Terrorism, A Psychological Exploration", American Psychologist;
- TERRA Toolkit – Community Approach to Radicalization;
- Terrorism and Violent Extremism Awareness Guide, Canada;
- Home grown terrorism and Islamist radicalisation in Europe;
- Community Policing To Counter Violent Extremism;
- Local Law Enforcement Responds to Terrorism, US Department of State;
- Effective Policing and Crime Prevention, US Department of State, Office of Community Oriented Policing Services;
- Australian Institute of Criminology – Intelligence Led-Policing

## PËRFUNDIM

Definitivisht, aplikimi dhe zbatimi efikas i konceptit të policimit në bashkësi është një nevojë e domosdoshme për avancimin e raporteve në mes të policisë dhe qytetarëve.

Për më tepër, kjo është një nevojë e vet anëtarëve të bashkësisë me qëllim që të adresojnë problemet e tyre të natyrave të ndryshme në mënyrë që të parandalojnë pasojë seriozë nga ndonjë vepër penale apo kundërvajtëse.

Zbatimi në mënyrë serioze dhe ndërlidhja e këtyre koncepteve do të avancojnë perceptimin e anëtarëve të bashkësisë për punën policore ku njëkohësisht përmes ngritjes së raportimit të rasteve të ndryshme nga ana e qytetarëve do të binte edhe numri i rasteve dhe dukurive të ndryshme negative në shoqërinë kosovare.

Përmes zbatimit efektiv dhe efikas të këtyre koncepteve, do të shtohet vullneti i zyrtarëve policorë që të punojnë në sektorët policorë, do të avancohet pozita e organizatës për zbatimin e ligjit në arenën rajonale dhe ndërkombëtare.

Mirëpo, përveç mënyrave të zbatimit të konceptit të policimit në bashkësi, është e domosdoshme edhe përdorimi i teknologjisë informative në zbatimin e këtij koncepti.

Duke e pasur parasysh përdorimin e jashtëzakonshëm të rrjeteve sociale përmes telefonave të mençur kryesisht nga të rinjtë, është e udhës që edhe koncepti i policimit në bashkësi të avancohet dhe të aplikohet policimi virtual duke shenjëstruar të rinjtë në rrjetet sociale.



[www.kosovopolice.com](http://www.kosovopolice.com)